



01/Nr. 6121/2024

Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, bëjë këtë:

### F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e shtatë -VII- të rregullt për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 30.07.2024 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2024.
3. Raporti i auditorit për pasqyrave financiare vjetore për vitin 2023 nga zyra kombëtare e auditimit.
4. Plani i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2023.
5. Kërkesë për plotësim ndryshimin e kërkesës me numër 04/5243/2024 për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore pasuri jofinanciare.
6. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2024.
7. Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2024 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
8. Informatë për sektorin e emergjencave.
9. Të ndryshme.

### Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-

- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e raportit financiar për periudhën Janar – Qershor 2024.
- Materialin e raportit të auditorit për pasqyrave financiare vjetore për vitin 2023 nga zyra kombëtare e auditimit.
- Materialin e planit të Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2023.
- Materialin e kërkesës për plotësim ndryshimin e kërkesës me numër 04/5243/2024 për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore pasuri jofinanciare.
- Materialin e informatës për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2024.
- Materialin e raportit financiar për periudhën Janar – Qershor 2024 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
- Materialin e informatës për sektorin e emergjencave.

Hani i Elezit  
Data:-19.07.2024

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta





01/Nr. 6922 / 2024  
Data: 19.07.2024

## PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e gjashtë -VI- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 27.06.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Lindita Ballazhi** (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë e Administratës), **Kimete Kuka –Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), Përfaqësues i OSB-së, **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2025-2027.
3. Rialokimi i mjeteve në kategorinë buxhetore pasuri jofinanciare.
4. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.
5. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:-për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim, rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Korniza afatmesme buxhetore 2025-2027.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- pas pranimit të qarkores buxhetore i kemi zhvilluar të gjitha procedurat për hartimin e kornizës afat mesme buxhetore, janë mbajtur dëgjimet buxhetore. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

**Resul Suma** thekson:- pse nuk është në asfaltimi i rrugës Hani i Elezit – Dimcë.

**Sherif Berisha** thekson:- edhe pse kam marr pjesë në dëgjimet që janë mbajtur me qytetarët disa propozime nuk janë përfshirë. Vërejtjet e mija janë sepse investimet kapitale janë të njëjta vetëm po barten dhe pse nuk specifikohen se ku bëhen projektet. Keni planifikuar pozita të reja por nuk shohim ndonjë ndryshim të madh në paga dhe mëditje krahasuar me vitin 2024. Te obligimet e arsimit dhe të shërbyesve civil a keni me i paguar dhe a keni planifikuar që vitin e ardhshëm për me i kryer këto obligime. A keni planifikuar që vitin e ardhshëm me ua paguar rrezikshmërinë inspektorëve sepse në këtë vit nuk kanë marr asgjë. Pse i keni rritur mallrat dhe subvencionet apo ndoshta mendoni me i subvencionuar militantët e juaj.

**Ajnore Thaqi** thekson:-sa i përket buxhetit në vitin 2025 diferencë janë 97000 € a është e mjaftueshme kjo shumë për me i pagur borxhet për mësimdhënësit që i keni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- nëse keni qenë në dëgjimet buxhetore dhe nëse ka pasur ndonjë propozim e nuk është përfshirë mundemi me përfshirë sepse për këtë arsye bëhet korniza afat mesme për përpilimin e draft buxhetit që do të jetë më vonë. Buxheti është ky dhe jepni propozimet e juaja se ku mendoni me ndarë këtë buxhet dhe e kemi përsërit disa herë që dëshirat tona dhe nevojat e qytetarëve dhe mundësitë buxhetore pra duhet të harmonizohen në mes veti. Sa i përket se a janë paraparë mjetet financiare është mirë që ti kalkuloni sepse buxheti është i juaji dhe duhet ta miratoni, mirëpo e mira e juve është që po ua sjellim si draft. Sa i përket projektit të rrugës Hani i Elezit –Dimcë është prej gjeoportalit dhe nuk është projekt por është një kërkesë për me bërë një rrugë. Militantizëm nuk ka që kanë përfituar dhe nuk është mirë me paragjykuar athu mos e keni rrit për me i financuar militantët e juaj por është mirë që të potenconi konkretisht.

**Resul Suma** thekson:-edhe kur është planifikuar buxheti kam potencuar që vetëm të jetë si kodë buxhetorë dhe i di mundësitë financiare për vitin 2024 por kam potencuar që në rast se Ministria që ka dhënë premtime që do të na ndihmon në infrastrukturë qyteteve të vogla ne të mbetet aty i gatshëm për me punuar. Është projekt ideorë dhe pas pranimit teknik bëhen paramanat për me vazhduar më tutje.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është një letër prej gjeoportalit dhe mund të ja jepni kujna do, është një letër A4 që është nxjerrë për me bërë një projekt po nuk ka asnjë të dhënë, mirëpo nëse e diskutojmë që me mbet si kod për një rrugë të caktuar mundemi por ne po e kërkojmë për shkak se e kërkojnë qytetarët me ndarë aq sa është e mundshme.

**Sherif Berisha** thekson:- edhe në mandatin e kaluar edhe në mandatin e juaj rruga transit e fshatit Gorancë vetëm është bartë. Në seancën e kaluar kam diskutuar me emra dhe është publike. Sa i përket subvencioneve në drejtorinë e kulturës shumat janë të njëjta dhe unë e shohë në këtë mënyrë dhe kam drejtë me potencuar . Propozim kam dhënë për lehonat që nga njëqind euro ne të bëhet dyqind euro. Për kategoritë e luftës është mirë që të uleni e të bisedoni dhe ne ta bëjmë një zgjidhje

**Mehmet Ballazhi** thekson:-nuk është fontanë dëshirash ju po propozoni dyqind euro e unë po propozojë një mijë euro, a është më mirë se dyqind euro por ne po bisedojmë se a kemi mundësi buxhetore me përmbushë qatë nevojë që e kanë qytetarët. Nëse e bëni ju sa për qytetarët për me ju dëgjuar në televizion mos u ndalni po a kemi mundësi me i mbuluar nuk kemi për shkak se mbi pesëdhjetë përqind e mjeteve shkojnë në paga e ju mund të planifikoni se ku doni me i dedikuar dhe në fund shikojeni sa po ju del.

**Sherif Berisha** thekson:- nëse keni vendosë një rast mortorë me paguar nga shumë prej 170 € në 250 € nuk e shohë problem për me paguar. Unë mund të tërhiqem prej gjitha kërkesave dhe mund ti dedikojmë mjetet në shtimin e kapaciteteve të ujit për shkak se nuk shohë asgjë që keni planifikuar për ujë për shkak se ujë nuk kemi.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- pse nuk ke ujë ty edhe të zezës mundesh me i thënë të bardhë edhe të bardhës e zezë por nuk e kam ndërmend me ta mbushur mendjen se a ka apo nuk ka ujë për shkak se qytetari është i kënaqur dhe unë e di që e ke mos pajtimin e sukseseve por ne kemi bërë punë të jashtëzakonshme për çështjen e rregullimit të ujit dhe është mirë të kontaktoni me qytetarë se ju mund të keni ndonjë problem personal me ujin që duhet me i bërë zgjidhje çfarëdo që të jetë por në nivel të qytetit në kërkesën e qytetarëve zgjidhja e problemit të ujit është bërë por nuk mund të them qind për qind se për cilësia e ujit jemi ti bërë analizat në mënyrë që me parë se sa është i pishëm por kapacitet të ujit dhe mjaftueshëm ujë ka, mirëpo probleme në rrjetë sigurisht që ka.

**Refet Kalisi** thekson:- unë i di kapacitet buxhetore për hapjen e rrugës në vendin e quajtur vorba dhe është mirë me bërë. Në debat publik i kam dhënë disa propozime dhe kërkoj që të përfshihet rrjeti i rrymës nëntokësore , nxemja në komunë me u bërë me pompë termike, propozoj që edhe trotuaret me kupëza në Han të Elezit mi ndërruar.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- propozoj që të bëhet rregullimi i përroit të rruga “Ismail Qemali” që një pjesë ka mbetur pa u rregulluar

**Lindita Ballazhi** thekson:- projektet që janë miratuar në muajin shtatorë të vitit 2023 për vitin 2024 i keni për këtë vit. Te lista e projekteve kapitale në kornizë afat mesme janë propozimet prej ekzekutivit dhe si material shtesë e keni edhe listën e propozuar nga qytetarët për projektet kapitale të cilat sot mund ti propozoni, ty shqyrtoni dhe ty votoni. Katër zyrtarët të cilët kanë qenë në drejtori të bujqësisë kanë kaluar në agjensionin pyjorë të Kosovës dhe ato pozita kanë mbetur në administratën komunale dhe ato pozita kemi mundur me i planifikuar për pozita të reja. Sa i përket obligimeve që i kemi në arsim për kontratën kolektive nuk planifikohet nga ne sepse është obligim i trashëguar nga dikush tjetër dhe gjithçka çka është planifikuar në këtë sektorë është duke u bazuar në grantin specifik të arsimit . Sa i përket rrezikshmërisë për inspektorët unë mund të ju pyes juve se nga e dini që nuk kemi planifikuar. Sa i përket mallrave dhe shërbimeve, subvencioneve ju mund ta shihni në planet e çdo drejtorie. Sa i përket pagave se a janë të mjaftueshme unë them se janë të mjaftueshme.

**Malik Berisha** thekson:- propozimet e qytetarëve i lexova dhe kërkoj që të hyjnë në kode propozimet që janë më prioritare për shkak se nuk kemi buxhet me i realizuar të gjitha propozimet që i kanë dhënë qytetarët.

**Hyriete Isufi** thekson:- u diskutua çështja e kontratës kolektive por a po kryhet në këtë vit dhe pastaj dihet sa ka mbetur buxhet dhe vazhdojmë tutje. Në KPF kam parashtruar pyetje për administratën e shëndetësisë për njëzet e dy punëtorë, mirëpo drejtoresha është përgjigjur se është dërguar e gatshme nga Ministria dhe a mundemi ne me ndryshuar atë numër.

**Zaim Bela** thekson:- u potencua se është bërë shumë për ujin e pishëm të qytetit por ka ankesa por rrjeti i ujësjellësit ku shpërndahet nëpër lagje nuk e dinë askush ka shkon për shkak se sasi e ujit që prodhohet në fabrikë është e mjaftueshme por uji është tu humbur dhe propozojë që të ndahen mjete financiar për rrjetin e ujësjellësit në mënyrë që ta kemi për në të ardhmen pra të bëhet një rrjet i ri . Me atë kanal të hyjnë edhe kabllot e rrymës. Katër pozitat që kanë qenë të autoriteti pyjorë a kanë mbetur si buxhet në mënyrë që dikendë me pranuar në bujqësi për shkak se drejtori ka mbetur vetë në drejtori të bujqësisë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kontratën kolektive në fillim por edhe në vitin që ka kaluar kam shprehur vullnetin publikisht për me i kryer pa varësisht se a kemi faj na apo nuk kemi dhe i kemi marr si borxhe dhe jemi të pafajshëm në këtë kuptim të institucionit. Jam mundur që me pasur mirëkuptim edhe me avokatët, me arsimtarë dhe me gjithë ata që janë faktor për me i zgjidhur këto probleme që së paku të kenë mundësi që me kursyer buxhetin e komunës për këto arsye që po flasim për realizim të projekteve që jemi zero por jemi nën zero, që tash që dali edhe kërkesa të tjera përveç shujtave, kualifikimit, inflacioni, orët shtesë që do të thotë buxheti i dy viteve për investime kapitale nuk është i mjaftueshëm për me i paguar këto obligime që i kemi na, ndërsa ne po diskutojmë për orientim buxheti me bërë projekte duke filluar prej rrugës baj pas në fshatin Gorancë, rrugën e Dimcës, rrugën për në Vorba dhe projekte të tjerë. Jemi në mungesë të buxhetit dhe po flasim për dëshira për projekte shtrohet pyetja se a mundemi sigurisht se jo. Çështja e kontratës kolektive nuk e dimë se a përfundon në këtë vit dhe me pasur mundësi e kishim kryer por kemi bërë kërkesa disa herë në thesar për me i ekzekutuar por nuk i kanë ekzekutuar. Sa i përket çështjes së ujit e kemi angazhuar që me bërë një projekt të tërësishëm për Hanin e Elezit për një rrjet të rijë duke filluar prej studimit të fizibilitetit në mënyrë që me ditë shumë për realizimin e këtij projekti. Ujë të mjaftueshëm ka sepse numri i banorëve nuk e kalon 8500 ndërsa ne po flasim për ujin e Dimcës që mund të jenë për 2500 banorë. Prodhoen 64000 litra në orë që do të thotë se janë tre fish më tepër sa që ka nevojë për me përdorë për shfrytëzuar atë ujë pra ujë ka të mjaftueshëm, ndërsa për çështje të keqpërdorimeve është çështje tjetër që jemi në proces që e kemi diskutuar me Bifurkacionin dhe do të del në teren me inspektoratin që e ka dhe ata merren me këtë problem se fundit është në domenin e tyre për menaxhimin e ujit.

**Sherif Berisha** thekson:- ne po i kontaktojmë të Bifurkacionit por nuk po e hapin telefonin, ndërsa komuna potencon që kemi bërë marrëveshje dhe si qytetarë ku duhet të trokasim na si qytetarë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- nëse ty nuk e dinë ku duhet me trokitur çka do të ju themi qytetarëve por me trokit duhet edhe te na në komunë por Bifurkacioni e ka përgjegjësinë për menaxhimin e ujit dhe dera që duhet të trokitet është Bifurkacioni që edhe në shpesh herë i thërrasim në telefon.

**Resul Suma** thekson:- para se me proceduar në votim kërkoj të kemi një pauzë prej pesë minuta.

**Kryesuesi** thekson:-nëse jeni në dakord si shefa të grupeve parlamentare e bëjmë një pauzë prej dhjetë minutave. Pas pauzës vazhdojmë me seancën fjalën ka drejtoresha e financave.

**Lindita Ballazhi** thekson:- në kornizën afatmesme buxhetore janë ato projekte që i kemi propozuar si ekzekutiv komunal për të cilat kemi menduar se janë më prioritare për qytetarin. Sa i përket kontratës kolektive vazhdimisht e kemi dërguar për ekzekutim në departamentin por nuk është ekzekutuar dhe nuk na lejojnë që të planifikojmë mjete dhe nuk e dimë se kur do të realizohen këto pagesa të cilat rrjedhin nga kontrata kolektive pasi që tash lëndët janë me përmbarrim. Numri i stafit është në sektorin e shëndetësisë primare që jo vetëm në komunën tonë por në shumë komuna ka një rritje drastike të stafit por nuk ka buxhet të lëshuar për të planifikuar atë staf, kështu që ne nuk mundemi me planifikuar staf pa financimin e tyre për shkak se nuk kemi buxhet për me financuar pagesën e atij stafi. Pozitat të cilat kanë qenë në drejtorinë e bujqësisë me buxhet kanë kaluar në agjensionin pyjorë të Kosovës dhe menaxhohen nga i njëjti agjensionë, ndërsa pozitat kanë mbetur në komunë në drejtorinë përkatëse dhe do të shohim se çka është më prioritet për komunën.

**Erblin Meliqi** thekson:- projekti i përroit të kollomoqeve është projekt i madh, komuna nuk mundet me realizuar për shkak të mjeteve buxhetore por është mirë me shtijë si projekt në mënyrë që përmes ndonjë donacioni me mundur me realizuar. Shkallët te lagjja e varrezave është mirë me shtijë si prioritet për vitin 2025.

**Kryesuesi** thekson:- janë organizuar dëgjimet buxhetore dhe janë dhënë propozimet mirëpo ne do t'i miratojmë propozimet që janë më me prioritet. Propozimi për rregullimin e rrugës baj pas dhe shpronësimi i sajë kërkoj që të hynë në kornizë afat mesme buxhetore . Rregullimi nëntokësorë i rrjetit elektrik në Han të Elezit. Rregullimi i nxehtë me pompë termike në komunë . Vendosja e skan kodeve të varrezat e dëshmorëve. Ndërtimi i rrugës dytësore ka stacioni i policisë që bëhet fjalë për vitin 2026 për shkak mundësive buxhetore. Ndërtimi i një trotuari nga shkolla deri te shitorja në fshatin Paldenicë pra bëhet fjalë për vitin 2025 . Projektet që ka të bëjnë me ujërat atmosferikë. Rruga për te lapidari Feriz dhe Gjevdet Guri është mirë të rregullohet dhe të mirëmbahet. Rregullimi i kanalizimit të Lagjja e Musallarve dhe rregullimi i kanalizimit të Lagjja e Barmallarët në fshatin Gorancë ty hynë për vitin 2025. Shtrimi me kupza betoni të varrezat e fshatit Gorancë. Shtrimi me kupza betoni dhe asfaltimi i rrugës deri te vendi i quajtur nën breg. Zgjerimi i rrugës te Kodra e Brahimit. Rihapja dhe rregullimi i rrugës në vendin e quajtur vorba të hynë si projekt për vitin 2026.

**Xhevahir Dernjani** thekson:- sa i përket projekteve për fshatin Paldenicë është rruga e cila lidhet ka policia që do të thotë e lidhë Paldenicën me lagjet për rreth.

**Resul Suma** thekson:-rregullimi i rrugës Hani i Elezit – Dimçë propozoj që të hynë për vitin 2025 dhe për rregullimin e parqeve nuk pat asnjë kod por është mirë që parku përballë komunës me u rregulluar.

**Hanumshahe Dibrni** thekson:-propozoj që të bëhet rregullimi i përroit të rruga “Ismail Qemali”.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim kornizën afat mesme buxhetore së bashku me propozimet ; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATU KORNIZA AFAT MESME BUXHETORE 2025-2027

### 3. Rialokimi i mjeteve në kategorinë buxhetore pasuri jofinanciare.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- kërkesa është hartuar sipas legjislacionit në fuqi. Në material janë të specifikuar në detale se në cilat projekte do të rialokohen mjetet

**Refet Kalisi** thekson:- shtrimi me kupza betoni të rruga “Isa Berisha” ku bëhet fjalë.

**Nexhmedin Daci** thekson:-ka pasur të bëjë me çështjen e lokaleve që kur të hiqen me u rregullua hapësira por është shtyrë për vitin e ardhshëm.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATU RIALOKIMI I MJETEVE NË KATEGORINË BUXHETORE PASURI JOFINANCIARE

### 4. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.

**Kryesuesi** thekson:- e kemi diskutuar edhe në KPF se në këtë komision të jena anëtarët e KPF-së ashtu siç kanë qenë edhe më herët. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUESË PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025

#### 4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Zaim Bela** thekson:- në mbledhjen e kaluar kam kërkuar përgjigje me shkrim prej zyrtarit ligjor por ende nuk kam marr përgjigje. Drejtori i urbanizmit ishte përgjigjur për çështjen e legalizimeve. Kur do të na dërgohen përgjigjet me shkrimë.

**Refet Kalisi** thekson:- e falënderoj drejtorinë e urbanizmit për përgjigjet por numri mu duk shumë i vogël prej 52 objekteve të legalizuara por çka mendojmë për në të ardhmen. Është mirë me sensibilizuar këtë çështje për shkak se e kemi obligim ligjorë.

**Resul Suma** thekson:-është marr një vendim për me i kompensuar kryetarët e këshillave të fshatrave, kërkoj sqarim për procedurat.

**Sherif Berisha** thekson:- është një numër i madh që kanë aplikuar për kompensimin e dëmeve, kërkoj informacion rreth dëmeve që janë bërë.

**Erbllin Meliqi** thekson:-banorët e fshatit Rezhancë kanë bërë kërkesë që rruga në vendin e quajtur Vakëf me u rregulluar deri te vendi i quajtur Kodra e Faslisë sepse është dëmtuar për shkak reshjeve të shiut

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sa i përket pyetjes që ja ke parashtruar zyrtarit ligjorë nuk e di saktë por edhe afatin se kur duhet me tu përgjigjur por besoj që ka afat dhe për shkak të volumit të punëve nuk ka mundur deri më tash me ua kthyer përgjigjen. Sa i përket reshjeve të fundit të breshrit, komisioni për vlerësimin e dëmeve është duke vazhduar dhe janë në teren por e kemi shtuar numrin e anëtarëve të komisionit për shkak numrit të madh të kërkesave 835 e që për secilin parashtrues të kërkesës është dashur me shkuar dhe me i verifikuar dëmet që janë shkaktuar nga breshëri dhe të gjitha ato fakte me dëshmi që i kanë mbledhur në koordinim me komisionin shtetërorë të vlerësimit të dëmeve pastaj bëhet një vlerësim real. Që në fillim kemi deklaruar që komuna nuk ka buxhet për këtë çështje dhe në takimin që e kemi pasur me komisionin shtetërorë të vlerësimit të dëmeve kemi kërkuar që së paku t'i mbështesë bizneset dhe ekonomitë familjare. Rruga në vendin e quajtur te Qarrat është dëmtuar por do t'i shohim mundësitë buxhetore.

**Natyra Kalisi** thekson:-sa i përket pagesës së këshillave të fshatrave jemi në proces për me gjetur formën e duhur.

**Nora Xhoni** thekson:- e shohë që te parku te Lepenci është duke u mirëmbajtur me një sistem të ujitjes dhe nuk e di a është e njëjta edhe për te parku "Isa Berisha". Është sezona e dasmave dhe është mirë me bërë një apel për shkak se fluksi i qytetarëve rritet ku do dhe është mirë që përmes KKSBS-së me i rekomanduar policisë që me pasur më shumë kujdes

**Mehmet Ballazhi** thekson:-edhe pse temperaturat janë të larta jemi munduar me mirëmbajtur parkun përmes një zgjidhjes mekanike për ujitjen e parkut që po merren edhe qytetarë vullnetarë por edhe ata të cilët janë të thirrur për këtë punë. Parku te Lepenci mirëmbahet më mirë për shkak se është hapësira më e vogël, ndërsa çështja e dukurive vandaliste është një problem në veti që gjithë secili është mirë me kontribuar ne vetëdijesim që mos me i dëmtuar te parku. Sa i përket sezonës së dasmave jemi në kontakte me policinë për këtë çështje.

**Hyriete Isufi** thekson:- lagjja jonë ka probleme me çështjen e ujit dhe nuk e di ku është problemi por edhe kur lëshohet uji kjo pjesë nuk ka ujë.

**Xhevahir Dernjani** thekson:- te drejtoria e arsimit çfarë është punuar më tepër për rregullimin e infrastrukturës shkollore.

**Malik Berisha** thekson:-orët e kujdestarisë së natës në QKMF a do të hyjnë në pagesë. Për shtimin e numrit të stafit a ka diçka konkrete.

**Hisni Luri** thekson:-gjatë këtyre viteve në drejtori të arsimit në rregullimin e infrastrukturës shkollore janë bërë këto punime duke filluar prej suvatimit të pjesshëm lyerja me ngjyrë adekuate pjesa e brendshme e shkollës fillore "Ilaz Thaçi", rregullimi i korridoreve me vinyl, muri mbrojtës dhe rregullimi i banjove në shkollën fillore "Ilaz Thaçi paralelja në fshatin Seçishtë, rregullimi i shkallëve hyrëse dhe emergjente në shkollën e mesme të lartë "Dardania" krijimi i kabinetit të biologjisë, shkallët emergjente, rregullimi banjove në shkollën e mesme të ulët "Kështjella e Diturisë", rregullimi i shkallëve emergjente dhe ndërimi i dritareve te aneksi i rijë, krijimi i kabinetit për histori dhe gjeografi, ndriçimi i klasave, rregullimi i tabelave të zeza në të bardha, lidhja e aneksit të shkollës me sallën e sporteve, në shkollën fillore "Veli Ballazhi" është bërë suvatimi i pjesshëm dhe lyerja e shkollës nga jashtë, rregullimi i parkingut për mësimdhënësit, rregullimi i shkallëve emergjente, rrethojat rreth sallës sportive.

**Kimete Kuka –Hasallari** thekson:- sa i përket orëve të kujdestarive unë nuk jam në dioni që nuk janë tu paguar por realisht jemi duke i paguar sipas Ligjit të ri të pagave dhe nëse dikujt nuk ju ka paguar kërkesa orientohet te drejtori i QKMF-së dhe përcillen tek unë për rimbursim të atyre orëve që kanë mbetur pa u paguar. Sa i përket numrit të pozitive nga vitin 2009 e deri në vitin 2024 Ministria nuk na ka lejuar por përveç një pozitive që e kemi orientuar për stomatologun që ka qenë më se i nevojshëm. Vullneti jonë është për me pasur staf për shkak se jemi në mungesë sepse gjysma e buxhetit të shëndetësisë po shkon me rekrutimin e marrëveshjeve që po bëhen me Islamik Reliefin dhe me Karitasin.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:11

**Procesmbajtësi**

**Ayni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Florim Shkreta**







REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA - MUNICIPALITY  
HANI I ELEZIT



Nr. 04 / 5785 / 2024

DATA :	09.07.2024
PËR :	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES :	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
NGA :	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2024

Të nderuar,

Bazuar në ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe Statutit të Komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 5, gjeni të bashkangjitur raportin financiar për periudhën janar-qershor 2024.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA - MUNICIPALITY  
HANI I ELEZIT



Nr. 04/5785/2024

# RAPORTI FINANCIAR JANAR-QERSHOR 2024

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA



Hani i Elezit, Korrik 2024

## **HYRJE**

Raporti financiar për periudhën janar - qershor 2024, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe Statutin e Komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 5. Ky raport përmban një përmbledhje të trendeve kryesore të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore përgjatë periudhës gjashtë mujore janar-qershor, 2024.

Raporti përmban analiza përmbledhëse të periudhës përkatëse, pasqyron të hyrat sipas drejtorive, sipas llojit të të hyrave si dhe krahasimet me periudhat paraprake dhe projeksionet buxhetore. Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Program Buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së Përgjithshme, Shëndetësisë Primare, Arsimit dhe Shkenca për periudhën Janar – Qershor 2024, duke përfshirë kategoritë ekonomike të pagave dhe mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere si dhe investimet kapitale.

Realizimin i të hyrave vetanake komunale dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyrë analitike si dhe krahasimi i tyre në raport me të njëjtën periudhë Janar-Qershor të vitit 2024/2023. Buxheti i Komunës për vitin 2024, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2024, për komunën Hani i Elezit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij. Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:

- Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,
- Një pasqyrë për të gjitha kategoritë buxhetore: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere si dhe investimet kapitale,
- Mundësinë e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive,
- Shprehja në përqindje e shfrytëzimit të buxhetit në periudhën përkatëse.

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për gjithë kategoritë buxhetore si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

## 1. BUXHETI KOMUNAL 2024

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2024 është në lartësi prej 3,349,278.00Euro.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

2. Paga dhe shtesa..... 2,075,272.00 €,
3. Mallra dhe shërbime.....524,500.00€,
4. Shpenzimet komunale.....93,500.00€,
5. Subvencione dhe transfere ...113,000.00€,
6. Shpenzime kapitale.....543,006.00€,
7. Totali i buxhetit..... 3,349,278.00 €.

Ndërsa buxheti përfundimtar është 3,944,620.44 €, ku në këtë shumë përfshihen:

1. Shuma e ndarë nga Grantet Qeveritare në shumë prej 3,074,901.87 €,
2. Projektioni i të hyrave vetanake Komunale në shumë prej 274,376.00 €,
3. Donacioni nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej 446,359.86 €.
4. Pjesë e mbetur e donacionit nga Qeveria Japoneze për projektin “Ndërtimi i aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës” në shumë prej 15,923.01 €.
5. Bartja e bilancit të pa shpenzuar nga viti 2023 në vitin 2024 në shumë prej 133,029.70 €.
6. Donacione të mbetura nga vitet paraprake në shumë prej 30.00 €.

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar - qershor 2024 është në shumë prej 1,534,321.17 €.

## 2. TË HYRAT VETANAKE

2.1 Të Hyrat Vetanake Komunale të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre për periudhën janar – qershor 2024/2023

Përshkrimi	Realizimi TM2 2024	Realizimi TM2 2023	Ndryshimi 2024-2023	Krahasimi 2024/2023
Të hyrat direkte	162,316.72	165,032.28	(2,715.56)	-1.64 %

**-Vërejtje:** në këtë tabelë të hyrat e realizuara për TM2 2024 dhe 2023 janë pa gjobot e trafikut dhe gjykatave.

2.2 Krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2024/2023

Nr	Kodi	Përshkrimi	Realizimi TM1 2024	Realizimi TM2 2023	Krahasimi në euro 2024-2023
			<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4=2-3</b>
<b>1</b>	50000	Të hyrat në pritje për shpërndarje	160	0	160
<b>2</b>	50013	Certifikatat e lindjes	149	21	128.00
<b>3</b>	50014	Certifikatat e kurorëzimit	210	290	(80.00)
<b>4</b>	50015	Certifikatat e vdekjes	10	6	4.00
<b>5</b>	50016	Certifikata tjera ofiqarie	2039	2,917.00	(878.00)
<b>6</b>	50017	Taksa për verifikimin e dok. të ndryshme	10	9	1.00
<b>7</b>	50019	Taksa tjera administrative	147.00	94	53.00
<b>I</b>	<b>163</b>	<b>Administrata e Përgjithshme</b>	<b>2,725.00</b>	<b>3,337.00</b>	<b>(612.00)</b>
<b>8</b>	40110	Tatimi në pronë dhe në tokë	44,303.94	99,409.52	-55,105.58
<b>10</b>	50001	Taksë për regjistrim të automjeteve	10,710.00	9,851.00	859.00
<b>II</b>	<b>175</b>	<b>Buxhet dhe Financa</b>	<b>55,013.94</b>	<b>109,260.52</b>	<b>-54,246.58</b>
<b>11</b>	50019	Taksa të tjera administrative	1,686.05	152.50	<b>1,533.55</b>
<b>12</b>	50208	Licenca për transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave	265.00		265.00
<b>13</b>	50212	Licenca për reklama dhe publikime në prona publike	1769.7	5,889.70	-4,120.00
<b>14</b>	50290	Licenca tjera për afarizëm	0	290.00	-290.00
<b>15</b>	50107	Gjobot tjera	0	-	0.00
<b>III</b>	<b>180</b>	<b>Shërbimet Publike</b>	<b>3,720.75</b>	<b>6,332.20</b>	<b>-2,611.45</b>
<b>16</b>	50012	Ndërrim destinimi i tokës	0	775	-775.00
<b>17</b>	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	0	0	0.00
<b>18</b>	50107	Gjoba tjera	0	0	0.00
<b>IV</b>	<b>470</b>	<b>Bujqësia dhe Zhvillimi Rural</b>	<b>0</b>	<b>775</b>	<b>-775.00</b>
<b>18</b>	50029	Të hyrat nga ushtrimi i veprimt. afariste	74,377.88	13,604.44	60,773.44

<b>19</b>	50104	Gjoba nga Inspektoriati		0	0.00
<b>20</b>	50205	Licenca për pranim teknik të lokalit	10	20	-10.00
<b>V</b>	<b>480</b>	<b>Zhvillimi Ekonomik</b>	<b>74,387.88</b>	<b>13,624.44</b>	<b>60,763.44</b>
<b>21</b>	50009	Taksa komunale për leje ndërtimi	5,887.75	11,745.96	(5,858.21)
<b>22</b>	50010	Taksa komunale për demolim		0	-
<b>23</b>	50011	Taksë për ndërrim të pronarit të pronës	2,480.00	2,910.00	(430.00)
<b>24</b>	50019	Shërbime të ndryshme kadastrale		4,498.00	(4,498.00)
<b>25</b>	50026	Taksë për legalizim të objekteve	306.09	0	306.09
<b>26</b>	50011	Taksa për regjistrimin e trashëgimisë		0	-
<b>27</b>	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	869.16	2,110.16	(1,241.00)
<b>28</b>	50413	Të hyrat nga shitja e pasurisë		1,000.00	(1,000.00)
<b>29</b>	50107	Gjobat nga inspektoriati		35	(35.00)
<b>30</b>	50111	Të hyra nga konfiskimi		0	-
<b>31</b>	50019	Taksa tjera administrative	5,129.00	0	5,129.00
<b>32</b>	50107	Gjobat tjera		0	-
<b>VI</b>	<b>660</b>	<b>Urbanizimi dhe Kadastri</b>	<b>14,672.00</b>	<b>22,299.12</b>	<b>-7,627.12</b>
<b>33</b>	50409	Participimet në Arsim	7,740.00	7,280.00	460.00
<b>VII</b>	<b>920</b>	<b>Arsimi</b>	<b>7,740.00</b>	<b>7,280.00</b>	<b>460.00</b>
<b>34</b>	50019	Taksa për shërbimet sociale	26.00	108	(82.00)
<b>35</b>	50409	Participimet në shëndetësi	3,936.15	2,016.00	1,920.15
<b>36</b>	50507	Inspektimi Higjeniko-Sanitar		0	-
<b>VIII</b>	<b>730</b>	<b>Shëndetësia dhe MS</b>	<b>3,962.15</b>	<b>2,124.00</b>	<b>1,838.15</b>
<b>37</b>	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	95.00	0.00	<b>95.00</b>
<b>IX</b>	<b>850</b>	<b>Kulturë, Rini dhe Sport</b>	<b>95.00</b>	<b>0.00</b>	<b>95.00</b>
<b>A</b>		<b>TË HYRAT DIREKTE</b>	<b>162,316.72</b>	<b>165,032.28</b>	<b>-2,715.56</b>
<b>38</b>	50101	Të hyrat nga dënimet në trafik	13,360.00	11,381.00	1,979.00
<b>39</b>		Të hyrat nga Agjensioni Pyjor	2,122.56	0	2,122.56
<b>40</b>	50102	Të hyrat nga dënimet në gjykata	-	0	0.00
<b>B</b>		<b>TË HYRAT INDIREKTE</b>	<b>15,482.56</b>	<b>11,381.00</b>	<b>4,101.56</b>
		<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM (A + B)</b>	<b>177,799.28</b>	<b>176,413.28</b>	<b>1,386.00</b>

### 2.3 Shpjegime për të hyrat vetanake

Projeksioni i të hyrave vetanake komunale për vitin 2024 është në shumë prej 274,376.00 €.

Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsej **162,316.72 €** nga të hyrat direkte për periudhën janar-qershor 2024 apo **59.1 %** e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2023 kemi një rënie për **2,715.56 €** apo **1.64 %**.

Në bazë të drejtorive për periudhën janar-qershor 2024 kemi inkasuar këto të hyra:

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka inkasuar të hyra në shumë prej **55,013.94€**;
- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka inkasuar të hyra në shumë prej **2,725.00 €**;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes Civile dhe Emergjencë ka inkasuar të hyra në shumë prej **3,720.75 €**;
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit ka inkasuar të hyra në shumë prej **74,387.88 €**;
- Drejtoria e Urbanizmit, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Kadastrit ka inkasuar të hyra në shumë prej **14,672.00 €**;
- Drejtoria e Arsimit ka inkasuar të hyra në shumë prej **7,740.00 €**;
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale ka inkasuar të hyra në shumë prej **3,962.15 €**;
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka inkasuar të hyra në shumë prej **95.00 €**.

### 3. REALIZIMI I BUXHETIT

#### 3.1 Shpenzimet sipas programeve (drejtoritë)

Programet(Drejtoritë)	Pagat dhe shtesat	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitalet	Totali i shpenzimeve
<b>Totali</b>	<b>1,119,864.18</b>	<b>224,946.14</b>	<b>39,028.55</b>	<b>74,421.00</b>	<b>76,061.30</b>	<b>1,534,321.17</b>
<b>GRANTI QEVERITAR (10)</b>	<b>1,119,864.18</b>	<b>214,651.11</b>	<b>39,028.55</b>	-	<b>7,358.60</b>	<b>1,380,902.44</b>
Zyra e Kryetarit	54,258.19	16,485.69	-	-	-	70,743.88
Administrata e Përgjithshme	48,832.84	31,733.82	20,174.98	-	-	100,741.64
Zyra e Kuvendit Komunal	64,342.20	1,567.10	-	-	-	65,909.30
Buxhet dhe Financa	32,716.10	2,486.94	-	-	-	35,203.04
Shërbime Publike dhe Emergjencia	41,778.25	54,133.58	-	-	7,358.60	103,270.43
Zyra lokale për Komunitete	600.14	-	-	-	-	600.14
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	7,509.61	68.00	-	-	-	7,577.61
Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi	13,439.88	3,165.00	-	-	-	16,604.88
Urbanizmi	34,851.60	3,249.80	-	-	-	38,101.40
Administrata e Shëndetësisë	7,492.28	-	-	-	-	7,492.28
Shërbimet e Shëndetësisë Primare	136,091.26	40,264.14	6,387.44	-	-	182,742.84
Shërbimet sociale	12,022.83	749.96	239.97	-	-	13,012.76
Shërbime Kulturore	14,476.15	2,101.20	1,752.88	-	-	18,330.23
Administrata e arsimit	14,440.81	22,478.70	-	-	-	36,919.51
Arsimi Parafillor dhe Çerdhet	38,384.12	4,436.98	969.00	-	-	43,790.10
Arsimi Fillor	517,774.20	30,068.30	8,223.32	-	-	556,065.82
Arsimi i Mesëm	80,853.72	1,661.90	1,280.96	-	-	83,796.58
<b>TË HYRAT VETANAKE-21</b>	-	<b>8,751.42</b>	-	<b>74,321.00</b>	-	<b>6,109.00</b>
Zyra e Kryetarit	-	-	-	33,299.00	-	33,299.00
Administrata	-	3,421.39	-	-	-	3,421.39
Shërbime Publike dhe Emergjencia	-	4,978.99	-	5,710.00	-	10,688.99
Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi	-	-	-	8,937.00	-	8,937.00
Bujqësia	-	-	-	6,000.00	-	6,000.00
Shërbimet e Shëndetësisë Primare	-	30.00	-	-	-	30.00
Administrata e Arsimit	-	-	-	20,375.00	-	20,375.00
Arsimi Parafillor dhe Çerdhet	-	321.04	-	-	-	321.04
<b>TË HYRAT E BARTUARA - 22</b>	-	<b>1,543.61</b>	-	<b>100.00</b>	<b>68,702.70</b>	<b>70,346.31</b>
Zyra e Kryetarit	-	-	-	100.00	-	100.00
Urbanizmi	-	-	-	-	68,702.70	68,702.70
Shërbimet e Shëndetësisë Primare	-	1,543.61	-	-	-	1,543.61



### 3.2 RAPORTI I KONTROLLIT BUXHETOR JANAR-QERSHOR 2024 NGA SIMFK

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paalokuar	Aktuali	Zotim /Obligimet në pritje	Buxheti FreeBalance
CAT / RESP / PCLASS / SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - ( C + D )
10 BUXHETI	<b>3,074,901.87</b>	<b>2,148,731.90</b>	<b>926,169.97</b>	<b>1,380,902.44</b>	<b>40,895.53</b>	<b>1,653,103.90</b>
659 HANI I ELEZIT	<b>3,074,901.87</b>	<b>2,148,731.90</b>	<b>926,169.97</b>	<b>1,380,902.44</b>	<b>40,895.53</b>	<b>1,653,103.90</b>
16035 ZYRA E KRYETARIT - HANI I ELEZIT	<b>143,348.99</b>	<b>88,258.19</b>	<b>55,090.80</b>	<b>70,743.88</b>	<b>255.40</b>	<b>72,349.71</b>
11 PAGA DHE SHTESA	109,348.99	54,258.19	55,090.80	54,258.19	0.00	55,090.80
13 MALLRA DHE SHËRBIME	34,000.00	34,000.00	0.00	16,485.69	255.40	17,258.91
16335 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	<b>228,083.00</b>	<b>185,305.39</b>	<b>42,777.61</b>	<b>100,741.64</b>	<b>18,154.83</b>	<b>109,186.53</b>
11 PAGA DHE SHTESA	92,083.00	49,305.39	42,777.61	48,832.84	0.00	43,250.16
13 MALLRA DHE SHËRBIME	80,000.00	80,000.00	0.00	31,733.82	17,585.95	30,680.23
14 SHPENZIME KOMUNALE	48,000.00	48,000.00	0.00	20,174.98	568.88	27,256.14
30 PASURITË JOFINANCIARE	8,000.00	8,000.00	0.00	0.00	0.00	8,000.00
16935 ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL - HANI I ELEZIT	<b>121,570.99</b>	<b>79,802.37</b>	<b>41,768.62</b>	<b>65,909.30</b>	<b>6,027.10</b>	<b>49,634.59</b>
11 PAGA DHE SHTESA	106,570.99	64,802.37	41,768.62	64,342.20	0.00	42,228.79
13 MALLRA DHE SHËRBIME	15,000.00	15,000.00	0.00	1,567.10	6,027.10	7,405.80
17535 BUXHETI - HANI ELEZIT	<b>65,144.99</b>	<b>35,716.10</b>	<b>29,428.89</b>	<b>35,203.04</b>	<b>52.41</b>	<b>29,889.54</b>
11 PAGA DHE SHTESA	62,144.99	32,716.10	29,428.89	32,716.10	0.00	29,428.89
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,000.00	3,000.00	0.00	2,486.94	52.41	460.65
18444 PARANDALIMI DHE INSPEKTIMI I ZJARRIT	<b>239,773.00</b>	<b>199,778.25</b>	<b>39,994.75</b>	<b>103,270.43</b>	<b>490.04</b>	<b>136,012.53</b>
11 PAGA DHE SHTESA	81,773.00	41,778.25	39,994.75	41,778.25	0.00	39,994.75
13 MALLRA DHE SHËRBIME	100,000.00	100,000.00	0.00	54,133.58	490.04	45,376.38
30 PASURITË JOFINANCIARE	58,000.00	58,000.00	0.00	7,358.60	0.00	50,641.40
19675 ZYRA LOKALE E KOMUNITETEVE - HANI I ELEZIT	<b>7,733.99</b>	<b>2,818.72</b>	<b>4,915.27</b>	<b>600.14</b>	<b>0.00</b>	<b>7,133.85</b>
11 PAGA DHE SHTESA	7,233.99	2,318.72	4,915.27	600.14	0.00	6,633.85
13 MALLRA DHE SHËRBIME	500.00	500.00	0.00	0.00	0.00	500.00
47115 PYLLTARIA INSPEKSIONI - HANI I ELEZIT	<b>36,273.99</b>	<b>14,866.41</b>	<b>21,407.58</b>	<b>7,577.61</b>	<b>53.00</b>	<b>28,643.38</b>
11 PAGA DHE SHTESA	34,273.99	12,866.41	21,407.58	7,509.61	0.00	26,764.38
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,000.00	2,000.00	0.00	68.00	53.00	1,879.00
48075 TURIZMI-HANI I ELEZIT	<b>36,448.99</b>	<b>22,939.88</b>	<b>13,509.11</b>	<b>16,604.88</b>	<b>2,299.90</b>	<b>17,544.21</b>
11 PAGA DHE SHTESA	26,948.99	13,439.88	13,509.11	13,439.88	0.00	13,509.11

<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	9,500.00	9,500.00	0.00	3,165.00	2,299.90	4,035.10
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	<b>356,771.99</b>	<b>326,443.76</b>	<b>30,328.23</b>	<b>38,101.40</b>	<b>0.00</b>	<b>318,670.59</b>
<b>11 PAGA DHE SHTESA</b>	70,123.99	39,795.76	30,328.23	34,851.60	0.00	35,272.39
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	17,000.00	17,000.00	0.00	3,249.80	0.00	13,750.20
<b>30 PASURITË JOFINANCIARE</b>	269,648.00	269,648.00	0.00	0.00	0.00	269,648.00
73044 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	<b>21,798.00</b>	<b>10,325.77</b>	<b>11,472.23</b>	<b>7,492.28</b>	<b>0.00</b>	<b>14,305.72</b>
<b>11 PAGA DHE SHTESA</b>	21,298.00	9,825.77	11,472.23	7,492.28	0.00	13,805.72
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	500.00	500.00	0.00	0.00	0.00	500.00
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - HANI I ELEZIT	<b>401,338.00</b>	<b>247,522.48</b>	<b>153,815.52</b>	<b>182,742.84</b>	<b>5,907.20</b>	<b>212,687.96</b>
<b>11 PAGA DHE SHTESA</b>	298,225.00	144,409.48	153,815.52	136,091.26	0.00	162,133.74
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	70,000.00	70,000.00	0.00	40,264.14	5,907.20	23,828.66
<b>14 SHPENZIME KOMUNALE</b>	14,500.00	14,500.00	0.00	6,387.44	0.00	8,112.56
<b>30 PASURITË JOFINANCIARE</b>	18,613.00	18,613.00	0.00	0.00	0.00	18,613.00
75671 SHËRBIMET SOCIALE - HANI ELEZIT	<b>27,858.99</b>	<b>15,822.83</b>	<b>12,036.16</b>	<b>13,012.76</b>	<b>44.11</b>	<b>14,802.12</b>
<b>11 PAGA DHE SHTESA</b>	24,058.99	12,022.83	12,036.16	12,022.83	0.00	12,036.16
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	2,800.00	2,800.00	0.00	749.96	36.12	2,013.92
<b>14 SHPENZIME KOMUNALE</b>	1,000.00	1,000.00	0.00	239.97	7.99	752.04
85035 SHËRBIMET KULTURORE-H.I ELEZIT	<b>45,799.99</b>	<b>31,242.10</b>	<b>14,557.89</b>	<b>18,330.23</b>	<b>1,245.12</b>	<b>26,224.64</b>
<b>11 PAGA DHE SHTESA</b>	29,799.99	15,242.10	14,557.89	14,476.15	0.00	15,323.84
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	12,000.00	12,000.00	0.00	2,101.20	998.00	8,900.80
<b>14 SHPENZIME KOMUNALE</b>	4,000.00	4,000.00	0.00	1,752.88	247.12	2,000.00
92175 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	<b>138,448.99</b>	<b>126,956.07</b>	<b>11,492.92</b>	<b>36,919.51</b>	<b>3,600.00</b>	<b>97,929.48</b>
<b>11 PAGA DHE SHTESA</b>	28,879.99	17,387.07	11,492.92	14,440.81	0.00	14,439.18
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	44,000.00	44,000.00	0.00	22,478.70	3,600.00	17,921.30
<b>30 PASURITË JOFINANCIARE</b>	65,569.00	65,569.00	0.00	0.00	0.00	65,569.00
92890 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET - HANI I ELEZIT	<b>100,192.99</b>	<b>53,061.32</b>	<b>47,131.67</b>	<b>43,790.10</b>	<b>777.06</b>	<b>55,625.83</b>

<b>11 PAGA DHE SHITESA</b>	87,192.99	40,061.32	47,131.67	38,384.12	0.00	48,808.87
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	10,000.00	10,000.00	0.00	4,436.98	756.58	4,806.44
<b>14 SHPENZIME KOMUNALE</b>	3,000.00	3,000.00	0.00	969.00	20.48	2,010.52
94020 ARSIMI FILLOR - HANI ELEZIT	<b>909,286.99</b>	<b>615,018.54</b>	<b>294,268.45</b>	<b>556,065.82</b>	<b>1,825.71</b>	<b>351,395.46</b>
<b>11 PAGA DHE SHITESA</b>	812,286.99	518,018.54	294,268.45	517,774.20	0.00	294,512.79
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	78,000.00	78,000.00	0.00	30,068.30	1,112.55	46,819.15
<b>14 SHPENZIME KOMUNALE</b>	19,000.00	19,000.00	0.00	8,223.32	713.16	10,063.52
95220 ARSIMI I MESËM - HANI I ELEZIT	<b>195,027.99</b>	<b>92,853.72</b>	<b>102,174.27</b>	<b>83,796.58</b>	<b>163.65</b>	<b>111,067.76</b>
<b>11 PAGA DHE SHITESA</b>	183,027.99	80,853.72	102,174.27	80,853.72	0.00	102,174.27
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	8,000.00	8,000.00	0.00	1,661.90	163.65	6,174.45
<b>14 SHPENZIME KOMUNALE</b>	4,000.00	4,000.00	0.00	1,280.96	0.00	2,719.04
21 TE HYRAT VETANAKE	<b>274,376.00</b>	<b>124,734.83</b>	<b>149,641.17</b>	<b>83,072.42</b>	<b>409.11</b>	<b>190,894.47</b>
659 HANI I ELEZIT	<b>274,376.00</b>	<b>124,734.83</b>	<b>149,641.17</b>	<b>83,072.42</b>	<b>409.11</b>	<b>190,894.47</b>
16035 ZYRA E KRYETARIT - HANI I ELEZIT	<b>46,000.00</b>	<b>46,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>33,299.00</b>	<b>0.00</b>	<b>12,701.00</b>
<b>20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE</b>	46,000.00	46,000.00	0.00	33,299.00	0.00	12,701.00
16335 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	<b>10,000.00</b>	<b>10,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>3,421.39</b>	<b>263.10</b>	<b>6,315.51</b>
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	10,000.00	10,000.00	0.00	3,421.39	263.10	6,315.51
18444 PARANDALIMI DHE INSPEKTIMI I ZJARRIT	<b>25,000.00</b>	<b>16,484.83</b>	<b>8,515.17</b>	<b>10,688.99</b>	<b>21.01</b>	<b>14,290.00</b>
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	5,000.00	5,000.00	0.00	4,978.99	21.01	0.00
<b>20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE</b>	15,000.00	11,484.83	3,515.17	5,710.00	0.00	9,290.00
<b>30 PASURITË JOFINANCIARE</b>	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00	0.00	5,000.00
47115 PYLLTARIA INSPEKSIONI - HANI I ELEZIT	<b>16,000.00</b>	<b>6,000.00</b>	<b>10,000.00</b>	<b>6,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>10,000.00</b>
<b>20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE</b>	16,000.00	6,000.00	10,000.00	6,000.00	0.00	10,000.00

48075 TURIZMI-HANI I ELEZIT	<b>10,000.00</b>	<b>10,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>8,937.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,063.00</b>
<b>20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE</b>	10,000.00	10,000.00	0.00	8,937.00	0.00	1,063.00
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	<b>111,176.00</b>	<b>3,000.00</b>	<b>108,176.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>111,176.00</b>
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	3,000.00	3,000.00	0.00	0.00	0.00	3,000.00
<b>30 PASURITË JOFINANCIARE</b>	108,176.00	0.00	108,176.00	0.00	0.00	108,176.00
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - HANI I ELEZIT	<b>5,000.00</b>	<b>5,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>30.00</b>	<b>0.00</b>	<b>4,970.00</b>
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	5,000.00	5,000.00	0.00	30.00	0.00	4,970.00
75671 SHËRBIMET SOCIALE - HANI ELEZIT	<b>200.00</b>	<b>0.00</b>	<b>200.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>200.00</b>
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	200.00	0.00	200.00	0.00	0.00	200.00
92175 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	<b>36,000.00</b>	<b>23,250.00</b>	<b>12,750.00</b>	<b>20,375.00</b>	<b>125.00</b>	<b>15,500.00</b>
<b>20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE</b>	26,000.00	23,250.00	2,750.00	20,375.00	125.00	5,500.00
<b>30 PASURITË JOFINANCIARE</b>	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00	0.00	10,000.00
92890 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET - HANI I ELEZIT	<b>15,000.00</b>	<b>5,000.00</b>	<b>10,000.00</b>	<b>321.04</b>	<b>0.00</b>	<b>14,678.96</b>
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	15,000.00	5,000.00	10,000.00	321.04	0.00	14,678.96
22 TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	<b>133,029.70</b>	<b>133,029.70</b>	<b>0.00</b>	<b>70,346.31</b>	<b>7,426.56</b>	<b>55,256.83</b>
659 HANI I ELEZIT	<b>133,029.70</b>	<b>133,029.70</b>	<b>0.00</b>	<b>70,346.31</b>	<b>7,426.56</b>	<b>55,256.83</b>
16035 ZYRA E KRYETARIT - HANI I ELEZIT	<b>297.58</b>	<b>297.58</b>	<b>0.00</b>	<b>100.00</b>	<b>0.00</b>	<b>197.58</b>
<b>20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE</b>	297.58	297.58	0.00	100.00	0.00	197.58
16335 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	<b>0.06</b>	<b>0.06</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.06</b>
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	0.06	0.06	0.00	0.00	0.00	0.06
18444 PARANDALIMI DHE INSPEKTIMI I ZJARRIT	<b>5,932.31</b>	<b>5,932.31</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>5,932.31</b>

<b>20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE</b>	3,030.00	3,030.00	0.00	0.00	0.00	3,030.00
<b>30 PASURITË JOFINANCIARE</b>	2,902.31	2,902.31	0.00	0.00	0.00	2,902.31
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	<b>124,022.16</b>	<b>124,022.16</b>	<b>0.00</b>	<b>68,702.70</b>	<b>7,426.54</b>	<b>47,892.92</b>
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	139.19	139.19	0.00	0.00	0.00	139.19
<b>30 PASURITË JOFINANCIARE</b>	123,882.97	123,882.97	0.00	68,702.70	7,426.54	47,753.73
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - HANI I ELEZIT	<b>2,682.67</b>	<b>2,682.67</b>	<b>0.00</b>	<b>1,543.61</b>	<b>0.02</b>	<b>1,139.04</b>
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	1,543.63	1,543.63	0.00	1,543.61	0.02	0.00
<b>30 PASURITË JOFINANCIARE</b>	1,139.04	1,139.04	0.00	0.00	0.00	1,139.04
92175 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	<b>9.00</b>	<b>9.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>9.00</b>
<b>30 PASURITË JOFINANCIARE</b>	9.00	9.00	0.00	0.00	0.00	9.00
92890 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET - HANI I ELEZIT	<b>68.17</b>	<b>68.17</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>68.17</b>
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	68.17	68.17	0.00	0.00	0.00	68.17
94020 ARSIMI FILLOR - HANI ELEZIT	<b>17.75</b>	<b>17.75</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>17.75</b>
<b>30 PASURITË JOFINANCIARE</b>	17.75	17.75	0.00	0.00	0.00	17.75
32 GRANTE TJERA TE JASHTME	<b>30.00</b>	<b>30.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>30.00</b>
659 HANI I ELEZIT	<b>30.00</b>	<b>30.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>30.00</b>
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	<b>30.00</b>	<b>30.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>30.00</b>
<b>30 PASURITË JOFINANCIARE</b>	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00
49 EU-UNIONI EUROPIAN	<b>446,359.86</b>	<b>446,359.86</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>446,359.86</b>
659 HANI I ELEZIT	<b>446,359.86</b>	<b>446,359.86</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>446,359.86</b>
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	<b>446,359.86</b>	<b>446,359.86</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>446,359.86</b>

<b>11 PAGA DHE SHITESA</b>	78,096.00	78,096.00	0.00	0.00	0.00	78,096.00
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	7.01	7.01	0.00	0.00	0.00	7.01
<b>30 PASURITË JOFINANCIARE</b>	368,256.85	368,256.85	0.00	0.00	0.00	368,256.85
59 QEVERIA JAPONEZE	<b>15,923.01</b>	<b>15,923.01</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>15,923.01</b>
659 HANI I ELEZIT	<b>15,923.01</b>	<b>15,923.01</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>15,923.01</b>
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	<b>15,923.01</b>	<b>15,923.01</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>15,923.01</b>
<b>13 MALLRA DHE SHËRBIME</b>	800.00	800.00	0.00	0.00	0.00	800.00
<b>30 PASURITË JOFINANCIARE</b>	15,123.01	15,123.01	0.00	0.00	0.00	15,123.01
Totali I Përgjithshëm	<b>3,944,620.44</b>	<b>2,868,809.30</b>	<b>1,075,811.14</b>	<b>1,534,321.17</b>	<b>48,731.20</b>	<b>2,361,568.07</b>


### 3.3 PËRQINDJA E REALIZIMIT DHE PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

Kategoritë buxhetore	Buxheti 2024	Buxheti i alokuar	Realizimi Janar-Qershor 2024	%	Buxheti 2023	Buxheti i alokuar	Realizimi Janar-Qershor 2023	%	Krahasimi në euro 2024/23	Krahasimi në % 2024/23
<b>Paga dhe shtesa</b>	2,075,272.00	2,153,367.87	1,119,864.18	52.01%	1,702,823.00	1,702,823.00	960,996.95	56.44%	158,867.23	16.53
<b>Mallra dhe shërbime</b>	524,500.00	525,307.51	224,946.14	42.82%	465,000.00	465,000.00	177,869.89	38.25%	47,076.25	26.47
<b>Shpenzime komunale</b>	93,500.00	93,500.00	39,028.55	41.74%	96,500.00	96,500.00	35,558.54	36.85%	3,470.01	9.76
<b>Subvencione dhe trans.</b>	113,000.00	113,000.00	74,421.00	65.86%	100,000.00	100,000.00	57,258.08	57.26%	17,162.92	29.97
<b>Pasuri Jofinanciare</b>	543,006.00	926,499.04	76,061.30	8.21%	985,392.00	987,281.66	29,439.15	2.98%	46,622.15	158.37
<b>TOTAL</b>	<b>3,349,278.00</b>	<b>3,811,674.42</b>	<b>1,534,321.17</b>	<b>40.25%</b>	<b>3,349,715.00</b>	<b>3,351,604.66</b>	<b>1,261,122.61</b>	<b>37.63%</b>	<b>273,198.56</b>	<b>21.66</b>

#### Komente dhe shpjegime:

- Pagesat nga kategoria ekonomike **paga dhe shtesa** janë shpenzuar në shumë prej 1,119,864.18 € ose 52.01 % të planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023 pagesat për këtë kategori kanë një rritje për 158,867.23 €.
- Pagesat për këtë kategori ekonomike **mallra dhe shërbime** për gjashtë mujorin e parë të vitit 2024 janë në shumë prej 224,946.14 € apo 42.82 % e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023 kemi një rritje prej për 47,076.25 €.
- Pagesat për **shërbime komunale** për TM2 2024 janë në shumë prej 39,028.55 € apo 41.74 % e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023 kemi një rritje prej 3,470.01 €.
- Pagesat nga kategoria **subvencione dhe transfere** për TM2 të vitit 2024 janë në shumë prej 74,421.00 € apo 65.86 % e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një rritje të shpenzimit prej 17,162.92 €.
- Pagesat nga kategoria **pasuri jofinanciare** për TM2 të vitit 2024 janë në shumë prej 76,061.30 €, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak shpenzimi për këtë kategori është në shumë prej 29,439.15 €.
- Gjithsej **shpenzimet për periudhën janar-qershor 2024**, për të gjitha kategoritë buxhetore janë në shumë prej 1,534,321.17 € apo 40.25 % e planit të përgjithshëm vjetor, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një rritje për 21.66 % apo 273,198.56 €.

### 3.4 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike





### 3.5 KATEGORIA PAGA DHE SHTESA SIPAS KODEVE EKONOMIKE

Kodi	Përshkrimi	Shpenzimi Janar-Qershor 2024	Shpenzimi Janar-Qershor 2023	Krahasimi 2024-2023	Krahasimi në %
<b>1</b>	<b>Paga dhe shtesa</b>				
<b>11111</b>	Pagat neto përmes listës së pagave	793,061.84	770,594.88	22,466.96	2.92
<b>11151</b>	Pagesa për sindikatë	1,655.91	1,585.80	70.11	4.42
<b>11121</b>	Tatimi në të ardhura personale	58,028.63	50,488.51	7,540.12	14.93
<b>11131</b>	Kontributi pensional-punëtori	47,339.02	42,832.40	4,506.62	10.52
<b>11152</b>	Odat profesionale	918.18	767.80	150.38	19.59
<b>11211</b>	Përvoja e punës	35,220.56	-	35,220.56	#DIV/0!
<b>11311</b>	Kontributi pensional-punëdhësi	47,339.02	42,832.40	4,506.62	10.52
<b>11411</b>	Shtesa e veçantë për të zgjedhurit	11,148.83	-	11,148.83	#DIV/0!
<b>11431</b>	Kujdestaria, puna gjatë natës & puna jasht orarit të punës	10,267.11	-	10,267.11	#DIV/0!
<b>11900</b>	Pagesa për vendime gjyqësore	114,885.08	51,895.16	62,989.92	121.38
	<b>Totali për paga dhe shtesa</b>	<b>1,119,864.18</b>	<b>960,996.95</b>	<b>158,867.23</b>	<b>16.53</b>

#### Shpjegime në kategorinë Paga dhe Shtesa:

**11111 – Pagat neto** - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2024 është 793,061.84 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak shpenzimi për këtë kod ekonomik është më i lartë për 22,466.96 € apo 2.92 % më shumë. Këtu përfshihen të gjithë pagat e rregullta neto për nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

**11121 – Tatimi në të ardhura personale** - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2024 është 58,028.63 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak shpenzimi për këtë kod ekonomik është më i lartë për 7,540.12 € apo 14.93 %. Këtu përfshihen të gjithë pagesat e tatimeve për të ardhurat personale për nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

**11131 – Kontributi pensional – Punëtori** - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2024 është 47,339.02 €. Këtu përfshihen 5% nga punëmarrësi e pagesës së kontributeve për nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

**11211 – Përvoja e punës** – Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për TM2 2024 është në shumë prej 35,220.56 €. Këtu përfshihet pagesa e përvojës për nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

**11311 – Kontributi pensional – Punëdhënësi** - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2024 është 47,339.02 €. Këtu përfshihen 5% nga punëdhënësi e pagesës së kontributeve për nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

**11411 – Shtesa e veçantë për të zgjedhurit** – Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2024 është në shumë prej 11,148.83 €. Këtu përfshihen shtesat e ndryshme deri në 30% të pagës bazë së Anëtarëve të Kuvendit Komunal, për pjesëmarrje në Komitetet e përhershme.

**11151 – Sindikatat** - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – mars 2024 është 826.39 €, në të cilën përfshihen pagesat për Sindikatë në Sektorin e Arsimit dhe Shëndetësisë.

**11152 – Odat profesionale** - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2024 është 918.18 € në Sektorin e Shëndetësisë.

**11431 - Kujdestaria, puna gjatë natës dhe puna jashtë orarit të punës** – Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2024 është 10,267.11 €. Këtu përfshihen shtesa të ndryshme të Sektorit të Arsimit dhe Shëndetësisë.

**11900 – Pagesa për vendime gjyqësore** - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2024 është në shumë prej 114,885.08 €. Këtu përfshihen pagesa me vendime gjyqësore të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive, Sektori i Arsimit.

### 3.6 KATEGORIA MALLRA DHE SHËRBIME SIPAS KODEVE EKONOMIKE

2	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimi Janar-Qershor 2024	Shpenzimi Janar-Qershor 2023	Krahasimi 2024-2023	Krahasimi në %
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit (transporti i nxënësve)	13,366.50	15,830.04	-2,463.54	84.44%
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit			0.00	#DIV/0!
13310	Interneti	1,473.30	1,430.00	43.30	103.03%
13320	Telefonia mobile	6,875.80	5,595.14	1,280.66	122.89%
13330	Shërbimet postare	650.19	84.30	565.89	771.28%
13141	Para xhepi/mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit	778.40	1,372.00	-593.60	56.73%
13142	Akomodimi-Udhëtimet zyrtare jashtë vendit			0.00	#DIV/0!
13143	Shpenzimet tjera të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit		110.00	-110.00	0.00%
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	4,000.00	-	4,000.00	#DIV/0!
13420	Shërbimet e përfaqësimit-avokaturës			0.00	#DIV/0!
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore	16,173.88	505.20	15,668.68	3201.48%
13440	Shërbime këshilldhënëse dhe profesionale	1,035.10	1,749.71	-714.61	59.16%
13445	Shërbimet e veçanta - konsulente dhe kontraktor individual	285.10		285.10	#DIV/0!
13450	Shërbimet e shtypjes/printimit	300.00	787.35	-487.35	38.10%
13460	Shërbime kontraktuese tjera	14,428.79	29,339.92	-14,911.13	49.18%
13470	Shërbime teknike	4,749.22	2,047.93	2,701.29	231.90%
13480	Shpenzimet për anëtarim	2,400.45	4,400.45	-2,000.00	54.55%
13501	Mobilje me pak se 1000 euro		1,000.00	-1,000.00	0.00%
13502	Telefona (më pak se 1000 euro)		999.50	-999.50	0.00%
13503	Kompjuter me pak se 1000 euro	595.00	5,061.00	-4,466.00	11.76%
13505	Makina fotokopjuese multifunksionale	2,781.00		2,781.00	#DIV/0!
13506	Paisje specialistike mjekësore më pak se 1000€			0.00	#DIV/0!
13509	Pajisje tjera me pak se 1000 euro	2,834.00	2,433.00	401.00	116.48%
13610	Furnizim për zyrë	10,136.82	5,517.95	4,618.87	183.71%
13620	Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	12,822.75	24,039.80	-11,217.05	53.34%
13630	Furnizime mjekësore	13,381.66	5,557.50	7,824.16	240.79%
13640	Furnizime pastrimi	5,790.35	5,544.47	245.88	104.43%
13650	Furnizim me veshmbathje		-	0.00	#DIV/0!
13660	Akomodim		-	0.00	#DIV/0!
13760	Dru		-	0.00	#DIV/0!
13770	Derivate për gjenerator		181.90	-181.90	0.00%
13780	Derivate për automjete, gjeneratorë dhe makineri	13,639.74	11,230.57	2,409.17	121.45%
13810	Avans për para të imëta	1,000.00	1,000.00	0.00	100.00%
13917	Provizioni Bankar		-	0.00	#DIV/0!
13950	Regjistrimi i automjeteve	610.00	600.00	10.00	101.67%
13951	Sigurimi i automjeteve	1,837.57	3,679.14	-1,841.57	49.95%
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	3,805.50	2,081.50	1,724.00	182.82%
14022	Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste	6,131.20	3,542.63	2,588.57	173.07%

<b>14023</b>	Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore	12,455.35	10,042.60	2,412.75	124.03%
<b>14024</b>	Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore	2,277.00	1,744.00	533.00	130.56%
<b>14032</b>	Mirëmbajtja e rrugëve lokale	49,107.98	19,357.80	29,750.18	253.69%
<b>14050</b>	Mirëmbajtja e mobiljeve dhe paisjeve	500.00	-	500.00	#DIV/0!
<b>14130</b>	Qiraja për paisje		1,459.99	-1,459.99	0.00%
<b>14140</b>	Qiraja për makineri		1,482.00	-1,482.00	0.00%
<b>14160</b>	Qiraja për automjete	205.81		205.81	#DIV/0!
<b>14210</b>	Reklamat dhe konkurset		-	0.00	#DIV/0!
<b>14220</b>	Botimet e publikimeve	495.00	-	495.00	#DIV/0!
<b>14310</b>	Kompensim i përfaqësimit brenda vendit	8,266.61	7,278.50	988.11	113.58%
<b>14410</b>	Shpenzime-vendimet e gjykatave	9,756.07	784.00	8,972.07	1244.40%
	<b>Totali për mallra dhe shërbime</b>	<b>224,946.14</b>	<b>177,869.89</b>	<b>47,076.25</b>	<b>126.47%</b>

### **Sqarime:**

**13130 - Transporti i udhëtimit zyrtar brenda vendit** - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2024 ka arritur në vlerë prej 13,366.50 €, për transportin e nxënësve për këto destinacione Krivenik – Hani i Elezit dhe anasjelltas, Kashan - Hani i Elezit dhe anasjelltas, Gorancë – Hani Elezit dhe anasjelltas si dhe Kaçanik – Hani i Elezit dhe anasjelltas.

**13310 – Interneti** - Shpenzimi për këtë kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e internetit në vlerë prej 1,473.30 € për nevojat e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

**13320 – Telefonia mobile** - Shpenzimi për këtë kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e telefonisë mobile në vlerë prej 6,785.80 € për nevojat e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

**13330 – Shpenzime postare** - Shpenzimi për këtë kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e shërbimeve postare në vlerë prej 650.19€.

**13141 - Para xhepi - Mëditje për udhëtime zyrtare jashtë vendit** – nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar 7 mëditje: një mëditje për pjesëmarrje në punëtori në Shqipëri, të organizuar nga Asociacioni i Kosovës me temë rreth Integritimeve në BE, një mëditje për puntorinë me temë Hartimi i rregullores për organizimin e brendshëm në vlerë prej 156.00 €, dy mëditje për vizitë studimore me temë për çështje ambientale, dy mëditje për konferencën e qeverisjeve lokale të organizuar nga ALDA, në Spanjë dhe një mëditje për vizitën e veçantë të “Kryetarëve të Komunave të Kosovës në Bashkinë Kavajë”.

**13410 - Shërbimet e arsimit dhe trajnimit** – Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar dy pagesa, një pagesë për Organizatën Kosovare për Talent dhe Arsim “Toka” në shumë për 3,000.00 € për trajnimin e Arsimitarëve dhe pagesa tjetër për Shoqatën Profesionale të informaticientëve të Kosovës “SHPIK” në shumë prej 1,000.00 €, për avancimin e kurrikulave, orë të kodimit etj.

**13460 – Shërbime kontraktuese tjera** – Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar këto pagesa, si vijon: shuma prej 7,717.64 € për Fondin e Kosovës për Efiçencë të Energjisë, pagesa e një mirëmbajtëse për objektin shëndetësor në shumë prej 400.00 €, shuma prej 695.40 € për Shërbimin Spitalor Klinik i Kosovës dhe 4,615.75 € për riparimin e shportave, ulëseve, salldimi dhe riparimi i mbrojtseve, pagesa ndaj DEA Group SHPK për hartimin e projektit “Asfaltimi i rrugës Ekzodi 99” në shumë prej 970.00 €,

**13470 – Shërbime teknike** – Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa për shërbime të zërimit, inçizime të manifestimeve të ndryshme, shënimin e datave, materiale me mbishkrime të ndryshme, xhirime të ndryshme dhe trasmetimi i seancave të Kuvendit Komunal në shumë prej 4,749.22 €.

**13480 – Shpenzime për anëtarësim** – Nga ky kod ekonomik është ekzekutuar pagesa e anëtarësisë në Asociacionin e Komunave në shumë prej 1,410.45 € si dhe 990.00 € për AZHR Lindje.

**13503 – Kompjuterë** – Pagesa e një laptopi për zyrtarë komunal, në shumë prej 595.00 €.

**13505 – Makina fotokopjuese / multifunksionale** – pajisja me makina fotokopjuese për nevojat e Administratës Komunale dhe Sektori i Arsimit në shumë prej 2,781.00 €.

**13509 – Pajisje tjera** – Nga ky kod ekonomik është ekzekutuar pagesa për blerjen e dy televizorave së bashku me pajisjet përcjellëse për nevojat e SHFMU “Kështjella e Diturisë”.

**13610 - Furnizim për zyrë** – nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa për furnizim me letër A4 për nevojat e Administratës Komunale dhe të Sektorit të Arsimit, furnizim me kapëse, folldera, markera, kimika, receta për barna, libreza për shkolla, dëftesa për klasë të ndryshme , diploma për nevoja të shkollave, libra me kurrikul, tonera për makina fotokopjuese, fletëza kompjuterike, etj në shumë prej 10,136.82 €.

**13620 - Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)** - te ky kod ekonomik janë përfshirë këto pagesa: ushqim dhe pije për nevojat e Çerdhes, dhe shërbimet e byfesë Komunale në vlerë prej 12,822.75 €.

**13630 – Furnizime mjekësore** – nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar këto pagesa, si vijon: 2,206.75 € për MADEKOS Shpk shpk për gjilpëra, ampulla, shiringa, sisteme të infuzionit dhe tableta të ndryshme, Genius Kosova për furnizim me ujë të destiluar, reagensa, epruveta, material të laboratorit,

në shumë prej 8,508.00 € dhe pagesa ndaj PRO MEDICAL SHPK për furnizime të ndryshme mjekësore në shumë prej 1,123.00 €.

**13640 – Furnizime Pastrimi** – nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa ndaj PM Group për furnizim me produkte të pastrimit për nevoja të Administratës Komunale, Sektori i Arsimit dhe Shëndetësisë në shumë prej 1,957.95 € dhe pagesa për SHPK KIGA në shumë prej 3,668.75 € për material higjienike.

**13780 – Derivate për automjete, gjeneratorë dhe makineri** - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për derivate për vetura të Administratës Komunale, Sektori Shëndetësisë, Zjarrëfiksant në vlerë prej 13,639.74 €.

**13950 – Regjistrimi i automjeteve** - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për regjistrimin e automjeteve komunale në vlerë prej 610.00 €,

**13951 – Sigurimi i automjeteve** - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për sigurimin e automjeteve Komunale në vlerë prej 1,837.57 €,

**14010 – Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve** - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për larjen, servisimin dhe riparimin e automjeteve komunale në vlerë prej 3,805.50 €,

**14022 – Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste** – Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa në shumë prej 6,131.20 € për furnizim me material për mirëmbajtjen e objekteve si psh: lopata alumini, kablllo të ndryshme, cilindra, brava për dyer, drita led, doreza për dritare, kablla vazhduese, furnizim me perde etj.

**14023 – Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore** – Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa në shumë prej 8,930.35 € ndaj NPL “Pastrimi” për mirëmbajtjen e objekteve arsimore dhe për furnizim me lopata alumini, kablllo të ndryshme, cilindra, brava për dyer, drita led, doreza për dritare, kablla vazhduese në shumë prej 3,525.00 €.

**14024 – Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore** – Nga ky kod ekonomik është ekzekutuar pagesa për mirëmbajtjen e Objektivit Shëndetësor, të angazhuar nga NPL “Pastrimi” në shumë prej 1,600.00 € dhe 677.00 € për furnizim me kondicioner.

**14032 – Mirëmbajtja e rrugëve lokale** – Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa në shumë prej 680.80 € për shenjzimin horizontal dhe vertikal ndaj KROSA TRAFFIC SIGNS SHPK, 1,909.20 € për mirëmbajtjen e autorrugëve lokale dhe 2,388.99 € për mirëmbajtjen e ndiçimit publik.

**14050 – Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve** – Nga ky kod ekonomik është ekzekutuar pagesa prej 500.00 € për mirëmbajtjen e pajisjeve për nevoja të QKMF-së.

**14160 – Qiraja për automjete** – Nga ky kod ekonomik është ekzekutuar pagesa për automjetin me qira në Sektorin e Shëndetësisë në shumë prej 205.81 €.

**14310 – Kompensimi i përfaqësimit Brenda vendit** – Pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën e TM2 2024 është në shumë prej 8,266.61 €.

**14410 – Pagesa me vendime gjyqësore** – Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa përmbareme nga Sektori i Arsimit, në shumë prej 9,756.07 €.

### 3.7 KATEGORIA SHPENZIME KOMUNALE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

3	Shpenzimet komunale	Shpenzimi Janar-Qershor 2024	Shpenzimi Janar-Qershor 2023	Krahasimi 2024-2023	Krahasimi në %
13210	Energjia Elektrike	22,175.40	30,319.52	-8,144.12	-26.86
13230	Mbeturinat	6,923.62	4,705.00	2,218.62	47.15
13250	Shpenzimet e telefonisë fikse	552.01	534.02	17.99	3.37
13220	Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	2,911.19	-	2,911.19	#DIV/0!
13260	Pagesat - Vendime Gjyqësore	6,702.93	-	6,702.93	#DIV/0!
	<b>Totali për shpenzime komunale</b>	<b>39,265.15</b>	<b>35,558.54</b>	<b>3,706.61</b>	<b>10.42</b>

#### **SQARIME:**

**13210 – Energjia Elektrike** – Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e energjisë elektrike për Administratën Komunale, Sektori i Arsimit, Sektori i Shëndetësisë dhe Zjarrëfiksat në shumë prej 22,175.40 €.

**13220 - Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit** – Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit për Administratën Komunale, Sektori i Arsimit, Sektori i Shëndetësisë dhe Zjarrëfiksat në shumë prej 2,911.19 €.

**13230 – Mbeturinat** - Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e mbeturinave për Administratën Komunale, Sektori i Arsimit, Sektori i Shëndetësisë dhe Zjarrëfiksat në shumë prej 6,923.62 €.

**13250 – Telefonia fikse** - Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e telefonisë fikse për Administratën Komunale dhe Sektori i Shëndetësisë në shumë prej 552.01 €.

**13260 – Vendime Gjyqësore** - Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesa përmbareme të Sektorit të Arsimit në shumë prej 6,702.93 €.

### 3.8 KATEGORIA SUBVENCIONE DHE TRANSFERE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

4	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimi Janar-Qershor 2024	Shpenzimi Janar-Qershor 2023	Krahasimi 2024-2023	Krahasimi në %
21200	Subvencione për entitete jo-publike	31,710.00	26,740.00	4,970.00	18.59
22202	Transfere për përfitues individual tjerë	41,712.00	-	41,712.00	#DIV/0!
22200	Transferet sociale për individë	999.00	30,518.08	-29,519.08	-96.73
	<b>Totali në subvencione dhe transfere</b>	<b>74,421.00</b>	<b>57,258.08</b>	<b>17,162.92</b>	<b>29.97</b>

#### SQARIME:

**21200 – Subvencione për entitete jo publike** – Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar 500.00 € për Shoqatën e parandalimit dhe largimit të rinisë, shuma prej 5,710.00 për Bashkësinë Islame për shpenzimet e varrimit, pagesa prej 25,000.00 € për mbështetjen financiare të Sektorit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe 500.00€ subvencionimi i Qendrës për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve – Dega Ferizaj.

**22200 – Transfere sociale për individe** – Pagesa nga ky kod ekonomik ka të bëjë me subvencionimin e një libri.

**22202 – Transfere për përfitues individual tjerë**– Nga ky kod ekonomik është ekzekutuar një pagesa për shërim jasht vendit, ndihma për banorë me kushte të vështira ekonomike dhe financiare, gjendje të rënda shëndetësore, pagesa të lehonisë, bursat studentore, në shumë prej 41,712.00 €.



### 3.9 KATEGORIA SHPENZIME KAPITALE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

5	Investimet kapitale	Shpenzimi Janar- Qershor 2024	Shpenzimi Janar- Qershor 2023	Krahasimi 2024-2023	Krahasimi në %
31121	Objekte arsimore	-	-	0.00	#DIV/0!
31122	Objekte shëndetësore	-	-	0.00	#DIV/0!
31123	Objekte kulturore	-	-	0.00	#DIV/0!
31124	Objekte sportive	-	-	0.00	#DIV/0!
31230	Ndërtimi i rrugëve lokale	47,358.60	-	47,358.60	#DIV/0!
31240	Trotuare	-	-	0.00	#DIV/0!
31250	Kanalizimi	28,702.70	-	28,702.70	#DIV/0!
31260	Ujësjiellësi	-	-	0.00	#DIV/0!
31270	Mirëmbajtja investive	-	-	0.00	#DIV/0!
31510	Furnizim me rrymë gjenerim & transmis.	-	-	0.00	#DIV/0!
31610	Paisje të teknologjisë Informative	-	-	0.00	#DIV/0!
31620	Mobilje	-	-	0.00	#DIV/0!
31660	Paisje tjera mjekësore	-	-	0.00	#DIV/0!
32100	Toka	-	2,540.00	-2,540.00	-100.00
32120	Parqet Nacionale	-	-	0.00	#DIV/0!
31690	Paisje tjera	-	-	0.00	#DIV/0!
33200	Transfere Kapitale-Entitete Jopublike	-	-	0.00	#DIV/0!
31702	Xhip dhe kombibus	-	-	0.00	#DIV/0!
34000	Pagesa-vendime gjyqësore	-	0.00	0.00	#DIV/0!
	<b>Totali për investime kapitale</b>	<b>76,061.30</b>	<b>2,540.00</b>	<b>73,521.30</b>	<b>2,894.54</b>



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA - MUNICIPALITY  
HANI I ELEZIT



Nr. 04/5787/2024

DATA:	09.07.2024
PËR:	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES:	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
NGA:	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA:	Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023

Të nderuar,

Gjeni të bashkangjitur Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023, me numër protokoli 982 të datës 26.06.2024.

Me respekt,



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga  
Vlora Spanca,  
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Hanit të Elezit (KHE), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Hanit të Elezit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

B1 Vonesa në pagesën e obligimeve financiare

B2 Zotimet e mjeteve dhe urdhërblereve në SIMFK pas pranimit të faturave.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetar i komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

ZKF është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, ZKF është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Hanit të Elezit.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Hanit të Elezit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Hanit të Elezit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Hanit të Elezit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Hanit të Elezit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.



## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: zotime të mjeteve dhe urdhërblereve në SIMFK pas pranimit të faturave, vonesa në pagimin e obligimeve financiare, keqklasifikim të shpenzimeve, dobësi në menaxhimin e pasurisë kapitale dhe jo kapitale, rritje të llogarive të arkëtueshme dhe me mos themelim të Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, prej tyre dy (2) rekomandime të reja dhe tri (3) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B1 - Vonesa në pagesën e obligimeve financiare

**Gjetja** LMFPP dhe Rregulla financiare Nr.01/2013/MF për shpenzimin e parave publike, përcakton se, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Në tri pagesa kemi identifikuar vonesa në ekzekutimin e faturave përtej afatit të përcaktuar. Vonesat ishin nga 3 deri 141 ditë pas afatit të përcaktuar prej 30 ditëve.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në menaxhimin dhe procesimin e pagesave.

**Ndikimi** Mos pagesa me kohë e obligimeve financiare rritë rrezikun e ankesave apo padive të mundshme nga kontraktuesit, dhe kjo mund të shkaktojë kosto shtesë financiare për Komunën.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B2 - Zotimet e mjeteve dhe urdhërblerjet në SIMFK pas pranimit të faturave

**Gjetja** Neni 22 i Rregulles Financiare Nr.01/2013/MF-Shpenzimi i parasë publike, përcakton procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave. Nga kjo, kërkohet që zotimi dhe urdhërblerja t'i paraprijë pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve, si dhe pranimit të faturës.

Gjatë testimi të pagesave kemi vërejtur se kërkesat për zotim për blerje në një rast dhe urdhërblerjet në katërmbdhjet (14) raste ishte lëshuar pas pranimit të faturave.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në zotimin e mjeteve dhe përgatitjen e urdhërblerjeve me kohë në SIMFK.

**Ndikimi** Përgatitja e zotimit dhe urdhërblerjeve me vonesë mund të vështiresoj procesin e menaxhimit financiar dhe ekzekutimin me kohë të pagesave ndaj kontraktuesve.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të siguroj që procesit të blerjeve t'i paraprijë zotimi i mjeteve financiare në SIMFK, dhe të vazhdohet me tej me përgatitjen e urdhërblerjes për punët, furnizimet apo shërbimet e kontraktuara.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

#### Çështja A1 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë kapitale dhe jokapitale

<b>Gjetja</b>	<p>Neni 6 paragrafi 3 i rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që - pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”. Po ashtu neni 11 paragrafi 1 dhe 2 i rregullores përcakton se pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim dhe nuk zhvlerësohen</p> <p>Komuna nuk i kishte paraqitur në regjistrin e pasurive mbi 1,000€ pagesat në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për projektin “Rregullimi I infrastrukturës shkollore” pagesat në shumat 17,718.25€;</li> <li>• “Ndërtimi I rrugëve locale” pagesën në vlerë 39,933.65€ dhe</li> <li>• “Ndërtimi I aneksit për këmbësor në rrugën e Secishtes” pagesën në vlerë 6,899.72€</li> </ul> <p>Po ashtu, kemi vërejtur se blerjet e vitit 2023, për pasuritë nën 1,000€, në vlerë 2,219.98€, nuk ishin regjistruar në regjistrat kontabël.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në menaxhimin e pasurisë</p>
<b>Ndikimi</b>	<p>Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat kontabël ndikon në nënvlerësim të pasurive dhe paraqitje jo të saktë të informative në PVF.</p>
<b>Rekomandimi A1</b>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejtë dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që Komuna ka në posedim.</p>

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.2 Të arkëtueshmet

### Çështja B3 - Rritje e llogarive të arkëtueshme

**Gjetja** Sipas nenin 26 të ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbarese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë eurove (10€). Gjithashtu, neni 27 përcakton që, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas dites se fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo me vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas dites që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna ka shpalosur në pasqyren financiare të vitit 2023 llogari të arkëtueshme në vlerë totale 353,018€. Llogaritë e arkëtueshme kanë tendence rritje dhe në krahasim me vitin paraprak rritja e tyre është 76,546. €

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në mbledhjen e të hyrave, mos marrja e veprimeve ligjore ndaj debitorve, si dhe nga bartja e borxheve të vjetra.

**Ndikimi** Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon negativisht në fondin buxhetor të komunes, me reflektim në financim dhe realizim të projekteve komunale.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes marrjes së veprimeve ligjore apo masave tjera informuese, me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

### Çështja A2 - Mos themelimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm

**Gjetja** Rregulloren QRK - NR 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 5 përcakton se çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi tre (3) milion euro themelon Njësinë e Auditimit të Brendshëm, e cila duhet të ketë se paku dy auditor.

Komuna e Hanit të Elezit edhe pse në vitin 2023 kishte buxhet mbi 4 milion katër (4) million nuk e kishte themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm.

Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime të duhura për ta trajtuar çështjen e themelimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

**Ndikimi** Mos themelimi i NjAB-së, përveç së është në kundërshtim me kërkesat ligjore i pamundëson menaxhmentit marrjen e veprimeve për parandalimin e gabimeve të mundshme në kohe sa me të hershme.

**Rekomandimi A2** Kryetari, duhet të marr veprime për themelimin dhe plotësimin e NJAB-së me staf të mjaftueshem sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>3,349,715</b>	<b>4,252,808</b>	<b>3,453,882</b>	<b>2,704,228</b>	<b>2,634,282</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	2,789,594	3,074,169	3,008,702	2,318,493	2,253,482
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	20,286	6,157
Të bartura nga viti i kaluar	0	125,257	115,613	62,486	57,002
Të hyrat vetanake	560,121	560,121	298,703	243,823	253,181
Donacionet vendore	0	30	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	493,230	30,864	59,140	64,459

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 903,093€. Kjo rritje është rezultat i grantit qeveritar, të hyrave të bartura nga viti i kaluar dhe financimi nga donacionet vendore dhe të jashtme. Në vitin 2023, Komuna ka shpenzuar 81% të buxhetit përfundimtar ose 3,453,882 €, me një ulje prej 10% në krahasim me vitin 2022. Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>3,349,715</b>	<b>4,252,808</b>	<b>3,453,882</b>	<b>2,704,228</b>	<b>2,634,282</b>
Pagat dhe mëditjet	1,702,823	2,065,494	1,987,398	1,694,968	1,644,863
Mallrat dhe shërbimet	465,000	477,586	472,647	396,616	348,741
Komunalitë	96,500	96,500	88,798	67,684	64,900
Subvencionet dhe transferet	100,000	101,033	86,955	85,967	72,465
Investimet Kapitale	985,392	1,512,195	818,084	458,992	503,312

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 362,671€. Kjo rritje ishte prej rishikimit të buxhetit. Shpenzimet në këtë kategori ishin 96% e buxhetit;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 12,586€. Kjo rritje ishte si rezultat i të hyrave vetanake dhe donacioneve. Në këtë kategori shpenzimet ishin 99% e buxhetit;
- Buxheti final për shërbimet komunale ka mbetur njësoj me atë fillestar 96,500€. Të kjo kategori, shpenzimi i buxhetit ishte 92%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur krahasuar me atë fillestar duke përdorur të hyrat vetanake. Shpenzimet ishin afro 86% e buxhetit; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 526,803€. Kjo rritje ishte prej buxhetit, donacioneve dhe të hyrave vetanake të bartura dhe aktuale. Donacioni nga Bashkimi Evropian në shumë prej 446,352.85 €, për projektin “A smart system for Early Floods Detection and Easte Monitoring in the Lepenc River Basin” ishte pranuar nga Komuna në muajin dhjetor 2023 dhe bazuar në Rregulloren MF-nr. 01/2018 për Përfundimin e Vitit Fiskal nuk ka mundur të shpenzohet në vitin 2023. Shpenzimet e buxhetit për investime kapitale pa e përfshirë shumën e donacionit janë 76.75%, ndërsa shpenzimi total i investimeve kapitale ishte 54% e buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga komuna në 2023 ishin në vlerë 358,132€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga qiraja etj. Në këtë vit të hyrat krahasuar me vitin 2022, ishin më të ulëta për 7% apo 24,130 €. Po ashtu, komuna për vitin 2023, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe të hyrat nga gjobat nga Agjensioni Pyjor i Kosovës në vlerë totale prej 63,946.68€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>560,121</b>	<b>560,121</b>	<b>358,132</b>	<b>334,002</b>	<b>316,657</b>
Të hyrat tatimore	222,737	222,737	160,835	163,301	139,134
Të hyrat jo tatimore	337,384	337,384	197,297	170,700	177,523



## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022, kishte rezultuar me 5 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë, dy (2) rekomandime janë zbatuar dhe tri (3) rekomandime nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese analizojnë dhe planifikojnë drejtë nevojat vjetore për furnizim, dhe se kontratat realizohen sipas kushteve dhe sasisë së kontraktuar.	Nuk kemi vërejtur tejkalim të sasive	I zbatuar
2.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që komisioni vlerësues të përdorë formularët standard të vlerësimit të kërkesave për subvencionim, si dhe përbërja e komisionit vlerësues të jetë sipas kërkesave të rregullores për financimin publik të OJQ-ve.	Nuk kemi hasur në raste të tilla	I zbatuar
3.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë që procesit të blerjeve ti paraprijë zotimi i mjeteve financiare në SIMFK, dhe të vazhdohet më tej me përgatitjen e urdhërblerjes për punët, furnizimet apo shërbimet e kontraktuara.	Nga testimet tona kemi vërejtur se janë lëshuar urdhërblerje pas pranimit të faturave.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve ligjore apo masave tjera informuese, me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.	Nuk ka ndryshim.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.	Edhe këtë vit kemi raste të mos pagesës me kohë të obligimeve.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.  
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



## Shtojca I: Letër konfirmimi



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Hanit të Elezit, për vitin 2023 ;
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Mehmet Ballazhi

Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit

Data: 19.06.2024



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA - MUNICIPALITY  
HANI I ELEZIT



Nr. 04/ 5788 /2024

DATA:	09.07.2024
PËR:	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES:	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
NGA:	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA:	Plani i veprimit të Komunës Hani i Elezit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin 2023.

**Të nderuar,**

Bazuar në nenin 14 të Rregullores së punës për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, Komuna Hani i Elezit ka përgatitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin 2023 të dalura nga Raporti i Auditimit të PVF-ve nga ZKA.

Duke e marrë në konsideratë Raportin e auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, në pajtim me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit jemi zotuar për adresimin e rekomandimeve të dhëna përmes planit të veprimit.

Poashtu, në kohë reale do të dorëzojmë Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e Auditimit dhe Planeve të veprimit.

Deri në fund të muajit tetor 2024 dhe prill 2025 do të diskutojmë në Kuvend Komunal për progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e Auditorit.

Me respekt,

Plani i veprimit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare 2023

Nr.	Komponenta e auditimit	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës / Drejtoria	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Çështja B1 – Vonesa në pagesën e obligimeve financiare	<p>LMPP dhe Rregulla Financiare Nr.01/2013/MF për shpenzimin e parave publike, përcakton se, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.</p> <p>Në tri pagesa kemi identifikuar vonesa në ekzekutimin e faturave përtej afatit të përcaktuar. Vonesat ishin nga 3 deri në 141 ditë pas afatit të përcaktuar prej 30 ditëve.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në menaxhimin dhe procesimin e pagesave. +</p>	Kryetari duhet të sigurojë se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.	Do të shtojm kontrollin e menaxhimit dhe procesimit të pagesave, në mënyrë që vonesat të eliminohen.	Njësitë kërkuese	Qershor-Dhjetor 2024	
2	Çështja B2 – Zotimet e mjeteve dhe urdhërblerjeve në SIMFK pas pranimit të faturave	Neni 22 i rregullës Financiare Nr.01/2013/MF – Shpenzimi i parasë publike, përcakton procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave. Nga kjo, kërkohet që zotimi dhe urdhërblerja t'i paraprijë pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve, si dhe pranimit të faturës.	Kryetari duhet të sigurojë që porcesit të blerjeve t'i paraprijë zotimi i mjeteve financiare në SIMFK, dhe të vazhdohet më tej me përgatitjen e urdhërblerjes për punët, furnizimet apo shërbimet e kontraktuara.	Do të shtojmë kontrollin në zotimin e mjeteve dhe do të bëhet përgatitja e urdhërblerjeve me kohë në SIMFK.	Do të shtojmë kontrollin në zotimin e mjeteve dhe do të bëhet përgatitja e urdhërblerjeve me kohë në SIMFK.	Qershor-Dhjetor 2024	

		<p>Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se kërkesat për zotim për blerje në një rast dhe urdhërblerjet në 14 raste ishin lëshuar pas pranimit të faturave.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në zotimin e mjeteve dhe përgatitja e urdhërblerjeve me kohë në SIMFK.</p>					
3	Çështja A1 – Dobësi në menaxhimin e pasurisë kapitale dhe jokapitale	<p>Neni 6 paragrafi 3 i rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jofinanciare në organizatat buxhetore përcakton që – pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jokapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”. Poashtu neni 11, paragrafi 1 dhe 2 i rregullores përcakton se pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim dhe nuk zhvlerësohen.</p> <p>Komuna nuk kishte paraqitur në regjistrin e pasurive mbi 1,000 € pagesat në vijim:  “Rregullimi i infrastrukturës shkollore” pagesa në shumat 17,718.25 €;  “Ndërtimi i rrugëve lokale” pagesa në vlerë 39,933.65 €,</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejtë dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që Komuna ka në posedim.</p>	<p>Do të shtohet kontrolli i menaxhimit dhe regjistrimit të pasurisë mbi dhe nën 1,000 € në sistemet relevante dhe në afatet e caktuara kohore.</p>	<p>Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.</p>	<p>Qershor-Dhjetor 2024</p>	

		<p>dhe “ Ndërtimi i aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës” pagesa në shumë prej 6,899.72 €.</p> <p>Poashtu kemi vërejtur se blerjet e vitit 2023, për pasuritë nën 1,000€, në vlerë 2,219.98 € nuk ishin regjistruar në regjistrat kontabël.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në menaxhimin e pasurisë.</p>					
4	Çështja B3 – Rritja e llogarive të arkëtueshme	<p>Sipas nenit 26 të Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë eurove (10 €). Gjithashtu, neni 27 përcakton që, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se 10 ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes marrjes së veprimeve ligjore apo masave tjera informuese, me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.</p>	<p>Do të shtojmë kontrollin në inkasimin e borxheve të vjetra, do të sigurojmë të jepen njoftimet për afatet e fundit të pagesave dhe do të ofrojmë që debitorët të kenë edhe mundësi të lidhin marrëveshje për pagesa me këste të borxheve.</p>	<p>Drejtoria për Buxhet dhe Financa,</p> <p>Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik,</p> <p>Drejtoria për Urbanizëm, Mbrojtje të Mjedisit dhe Kadastrit.</p>	<p>Qershor-Dhjetor 2024</p>	

		<p>Komuna ka shpalosur në pasqyrën financiare të vitit 2023 llogari të arkëtueshme në vlerë totale 353,018€.</p> <p>Llogaritë e arkëtueshme kanë tendencë rritje dhe në krahasim me vitin paraprak rritja e tyre është 76,546€.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në mbledhjen e të hyrave, mosmarrja e veprimeve ligjore ndaj debitorëve, si dhe nga bartja e borxheve të vjetra.</p>					
5	<p>Çështja A2 – Mos themelimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm</p>	<p>Rregullore QRK – Nr01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të Auditimit të Brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 5 përcakton se çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi 3 milion euro themelon Njësinë e Auditimit të Brendshëm, e cila duhet të ketë së paku dy auditor.</p> <p>Komuna e Hanit të Elezit edhe pse në vitin 2023 kishte buxhet mbi 4 milion nuk e kishte themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm .</p> <p>Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime të duhura për të trajtuar çështjen e themelimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm .</p>	<p>Kryetari duhet të marrë veprime për themelimin dhe plotësimin e NJAB-së me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohësisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.</p>	<p>Do të bëjmë kërkesa të vazhdueshme në Ministrinë e Linjës për aprovimin e një pozite të re në OB, do të ndryshohet Statuti i Komunës dhe do të propozohet të krijohet Njësia e Auditimit të Brendshëm</p>	<p>Drejtoria për Buxhet dhe Financa,</p> <p>Zyra e Kryetarit,</p> <p>Drejtoria e Administratës së Përgjithshme</p>	<p>Qershor-Dhjetor 2024</p>	





Republika e Kosovës-Republic of Kosova  
Ndërmarrja Publike Lokale  
"PASTRIMI" SH.A  
Hani Elezit



01/Nr. 5735 /2024

<b>Data:</b>	05.07.2024
<b>PËR:</b>	KPF dhe Kuvendin e Komunës së Hanit të Elezit
<b>PËRMES:</b>	Kryesuese e Komisionit të Aksionerëve – znj. <u>Sejme Bajrami</u>
<b>NGA:</b>	Ndërmarrja Publike Lokale e Mbeturinave NPL "PASTRIMI" SH.A
<b>LËNDA:</b>	Informatë mbi Raportin gjashtëmuor Janar – Qershor /2024

Të nderuar anëtarë të KPF-së dhe Kuvendit të Komunës

Me anë të këtij raporti, ju përcjellim informatën për raportin gjashtëmuor Janar – Qershor /2024, për Ndërmarrjen Publike Lokale të Mbeturinave - Npl "Pastrimi" Sh.a. si dhe pergjigjet e pyetjeve të kërkuara nga assembleistët ne lidhje me kompaninë.

Me respekt,



Republika e Kosovës - Republic of Kosova  
Ndërmarrja Publike Lokale  
"PASTRIMI"SH.A  
Hani i Elezit



Nr.Prot. 63/ 2024

<b>Data:</b>	05.07.2024
<b>PËR:</b>	KPF dhe Kuvendin e Komunës së Hanit të Elezit
<b>PËRMES:</b>	Kryesues i Komisionit të Aksionarëve – znj.Sevime Bajrami
<b>NGA:</b>	Ndërmarrja Publike Lokale e Mbeturinave - NPL"PASTRIMI" SH.A
<b>LËNDA:</b>	Informatë mbi raportin për periudhën Janar – Qershor / 2024 – Npl "Pastrimi" Sh.a

Të nderuar anëtarë të KPF-së dhe Kuvendit të Komunës

Ne kete raport janë te pasqyruara aktivitet operative dhe financiare per periudhën Janar – Qershor / 2024 për Ndërmarrjen Publike Lokale të Mbeturinave - Npl "Pastrimi" Sh.a.

---

**Informatë mbi raportin Janar - Qershor / 2024 të NPL"PASTRIMI" SH.A**

---

Me respekt.

**RAPORTI PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR / 2024, I NDËRMARRJES PUBLIKE  
LOKALE TË MBETURINAVE - NPL"PASTRIMI" SH.A**

Ky raport është përgatitur për periudhën Janar – Qershor / 2024, në bazë të ligjit për Ndërmarrjet Publike - Ligjit Nr.03/L-087, të nenit 31 dhe nenit 14, paragrafit 14.2 dhe Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Pastrimi" Sh.a.



Ndërmarrja Publike Lokale – NPL “PASTRIMI” SH.A, bënë menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Hanit të Elezit, ku përfshihen të gjitha lokalitetet e Komunës.

Ndërmarrja Publike Lokale – Npl “Pastrimi” Sh.a, ka gjithësej njëzet e një punëtor (21) punëtorë :-

- 1 Kryeshef Ekzekutiv
- 1 Sekretar i Ndërmarrjes
- 1 Arkëtare (ushtruese detyre e ZKF –së)
- 1 Zyrtar i Prokurimit
- 1 Inkasant
- 1 Mirembajtës i parqeve publike
- 3 Shofer
- 4 Punëtor teknik
- 8 Pastrues (Grumbullues të mbeturinave)

Sa i përket kësaj periudhe Janar – Qershor 2024, mund të themi se gjatë kësaj periudhe ka qenë një periudhë me mjaft me aktivitete nga punëtorët e ndërmarrjes publike lokale “Pastrimi”. Gjatë kësaj periudhe punëtorët e kompanisë kanë qenë të angazhuar në terren në kryerjen e shërbimit të mbeturinave dhe njëkohësisht kanë kryer pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve në qendër të Hanit të Elezit, pastrimin e rrugëve në fshatra përreth, pastrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve në Pustenic, pastrimin dhe mirëmbajtjen e parkut të qytetit “Isa Berisha”, krasitjen e pemëve dekorative në qendër të Hanit të Elezit, pastrimin e rrugëve nga dëmet që shkaktoj breshëri në muajin maj, ndërrimin e llusterav dekorativ të dëmtuar të varrezat e dëshmoreve si pasojë e breshërit. Në muajin prill kemi pranuar anëtarin e ri të bordit si plotësim i vendit të lirë të punës tanimë të ndjerit Nazmi Suma. Në muajin maj kemi lidhur një Aneks Marrëveshje me komunën përmes drejtorisë Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për pranimin e një Puntore Teknike për mirëmbajtjen e QKMF-së (ambulanta familjare). Ndërsa në muajin qershor kemi shpërndarë mbi 320 zarfa me njoftime për klientët borxhlinjë, gjithashtu i kemi njoftuar edhe përmes ueb faqes zyrtare të kompanisë “Pastrimi”, ku disa prej këtyre borxhlinjve ju kanë përgjigjur thirrjes sonë me kryerjen e obligimit të borxhit ndaj kompanisë.

**Lista e punëtorëve të NPL-së, pozita e vendit të punës dhe paga e tyre si vijon:-**

Nr.	Pozita	Nr. Punëtorëve	Paga Bruto
1	Kryeshefi Ekzekutiv	1	836.82
2	Sekretar i Ndërmarrjes	1	524.21
3	Arkëtare	1	524.21
4	Mirëmbajtës i parqeve publike	1	403.35
5	Shofer	2	468.84
6	Shofer – mbykqyres i punëtorve në teren	1	524.21
7	Inkasant	1	468.84
8	Grumbullues i mbeturinave	8	403.35
9	Punëtor teknik	4	403.35
10	Zyrtar i prokurimit	1	155.86
11	<b>TOTALI I STAFIT TË NPL-SË</b>	<b>21</b>	

Gjatë periudhës Janar – Qershor / 2024, janë mbajtur pesë (5) mbledhje me Bordin e Drejtorëve të Npl "Pastrimi" Sh.a.

Çmimoret e kontratave janë:-

- Kontratë familjare **6.50€**, në muaj,
- Kontratë e mesme **10.40€**, në muaj,
- Kontratë me zbrazje **16.90€**, për çdo zbrazje të kontenjerit **1100L**.

Gjatë periudhës Janar – Qershor / 2024 janë nënshkruar disa kontrata me klient të rinj të Npl "Pastrimi" Sh.a, ato janë:-

- Kontratë familjare **2**,
- Kontratë biznesore **6**,
- Institucionale **1**.

**Totali i kontratave të nënshkruara nga viti 2017 – Qershor / 2024 janë si vijon:-**

- **Ekonomitë familjare ----- 1490**
- **Kontratë biznesore ----- 108**
- **Kontratë institucionale ----- 11**
- **Totali i kontratave ----- 1609**

## 1. Hyrje

Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2024, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të nenit 14, paragrafët 14.2 si dhe statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale.

Ky raport përmban një përmbledhje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore të kompanisë së mbeturinave përgjatë periudhës Janar – Qershor 2024. Raporti pasqyron të hyrat e kompanisë, si dhe krahasimet me periudhën paraprake. (nese mundem me e gjet raportin per periudhen krahasuese 2023)

### 1.1. Performanca e të hyrave nga shërbimet

**Të hyrat nga shërbimet** në periudhën raportuese Janar – Qershor 2024 kanë arritur vlerën 114,594.93 euro duke shënuar trende rritëse me 24.45% që korrespondon me 22,512.27 euro më shumë krahasuar me të hyrat e vitit 2023.

### Performanca e shpenzimeve të kompanisë

**Shpenzimet e kompanisë** në periudhën raportuese kanë arritur vlerën prej 110,172.58 euro duke shënuar një rritje prej 19.66 % që korrespondon me 18,101.15 euro më shumë krahasuar me vitin paraprak.

- **Shpenzimet për paga dhe mëditje** në periudhën raportuese shënuan vlerën e 63,136.60 € duke shënuar një rritje prej 8,678.34 € apo 15.94% krahasuar me vitin 2023.
- **Shpenzimet në tatime** në periudhën raportuese shënuan vlerën e 4,823.62 euro duke shënuar një rritje prej 2,119.36 euro ose në përqindje 78.37% më shumë krahasuar me vitin 2023.
- **Shpenzimet për mallra dhe shërbime** në periudhën raportuese shënuan vlerën prej 42,212.369 € duke shënuar një rritje prej 7,303.45 € apo 20.92 % krahasuar me vitin 2023.

## 2. TË HYRAT E KOMPANISË

.	TE HYRAT	2023	2024	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	Të hyrat nga Shërbimet	89,280.20	110,450.89	21,170.69	23.71%
2	Te hyra tjera	756.00	3,633.00	2,877.00	380.56%
3	Paraja në bankë	2,046.46	511.04	(1,535.42)	-75.03%
	<b>TOTALI</b>	<b>92,082.66</b>	<b>114,594.93</b>	<b>22,512.27</b>	<b>24.45%</b>

## 3. SHPENZIMET E KOMPANISË

### 3.1 PAGA DHE MEDITJE

A	PAGAT DHE MEDITJET	2023	2024	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	PAGAT NETO + SHUJTA	47,053.18	54,623.99	7,570.81	16.09%
2	KONTRIBUTI I PUNEMARRSIT	2,685.20	3,000.69	315.49	11.75%
3	KONTRIBUTI I PUNEDHENESIT	2,685.20	3,000.69	315.49	11.75%
4	TATIMI NE BURIM	2,034.68	2,511.23	476.55	23.42%
	<b>TOTALI</b>	<b>54,458.26</b>	<b>63,136.60</b>	<b>8,678.34</b>	<b>15.94%</b>

### 3.2 TATIMET

B	TATIMET	2023	2024	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	TVSH-ja 8%	2,354.26	4,823.62	2,469.36	104.89%
2	KESTET TREMUJORE (ATK)	-	-	-	0.00%
3	TATIMI VJETOR MBI KORPORATA	350.00	-	(350.00)	-100.00%
	<b>TOTALI</b>	<b>2,704.26</b>	<b>4,823.62</b>	<b>2,119.36</b>	<b>78.37%</b>

### 3.3 MALLRA DHE SHERBIME

C	MALLRA DHE SHËRBIME	2023	2024	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	Shpenzime për karburant	13,741.79	11,122.92	(2,618.87)	-19.06%
2	Shpenzimet e deponisë (KMDK)	5,433.26	8,311.90	2,878.64	52.98%
3	Shpenzimet për internet	75.00	127.12	52.12	69.49%
4	Shpenzimet e Mirëmbajtjes se Mjeteve	6,478.40	10,932.71	4,454.31	68.76%

5	Furnizim me Rërë I II III			-	0.00%
6	Shpenzime për Softuer Kompjuterik	295.00	500.00	205.00	69.49%
7	Shpenzime per zyre dhe administrative	1,675.35	2,167.83	492.48	29.40%
8	Shpenzime për zyre pajisje dhe mjete pune	4,404.80	6,382.35	1,977.55	44.90%
9	Shpenzime për trajnime	790.00		(790.00)	-100.00%
10	Shpenzimet e Reprerentacionit	293.20	436.30	143.10	48.81%
11	Shpenzimet e Sigurimit	683.86	9.03	(674.83)	-98.68%
12	Shpenzime Telefoni - (Mbushje)	458.95	602.40	143.45	31.26%
13	Provizione Bankare NLB BANK	79.30	75.80	(3.50)	-4.41%
14	Çertifikata për shofer kamioni			-	0.00%
15	Çertifikata shëndetsore			-	0.00%
16	Licence	500.00		(500.00)	-100.00%
17	Uniforma Pune	-		-	0.00%
18	Shpenzimet e rrymes	-		-	0.00%
19	Shpenzimet e pazbritshme per qeshtje tatimore	-	1,544.00	1,544.00	100%
	<b>TOTALI</b>	<b>34,908.91</b>	<b>42,212.36</b>	<b>7,303.45</b>	<b>20.92%</b>

### 3.4 TOTALI I TE HYRAVE DHE SHPENZIMEVE

	TE HYRAT	2023	2024	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	Të hyrat nga Shërbimet	89,280.20	110,450.89	21,170.69	23.71%
2	Te hyra tjera (Ministria e Punes)	756.00	3,633.00	2,877.00	380.56%
3	Paraja në bankë	2,046.46	511.04	(1,535.42)	-75.03%
	<b>TOTALI</b>	<b>92,082.66</b>	<b>114,594.93</b>	<b>22,512.27</b>	<b>24.45%</b>
	<b>SHPENZIMET</b>				
	Shpenzime Tjera A+B+C+D+E	92,071.43	110,172.58	(18,101.15)	-19.66%
	<b>Fitimi/Humbja</b>	<b>11.23</b>	<b>4,422.35</b>	<b>4,411.12</b>	<b>39279.79%</b>

Hani i Elezit  
05.07.2024

Zyra e Npl "Pastrimi" Sh.a  
Hani i Elezit

## Llogaritja e te hyrave dhe shpenzimeve Janar - Qershor 2024

N.P.L. " PASTRIMI " SH.A  
NRU: 81116271  
Hua i Dëzoi Rr. " Dëshmorët e Kombit "

TE HYRAT	JANAR	SHKURT	MARS	4	5	6	7	8	9	10	11	12	TOTALI
1 Te hyrat nga Shërbimet	19,822.50	26,873.07	23,059.26	13,206.88	13,962.86	13,526.32							110,450.89
2 Te Hyra Tjera (Ministria e Punes)	-	1,281.00	1,302.00	525.00	525.00								3,633.00
3 Paraja në bankë (Xhirologjaria 2023)	511.04												511.04
<b>TOTALI</b>	<b>20,333.54</b>	<b>28,154.07</b>	<b>24,361.26</b>	<b>13,731.88</b>	<b>14,487.86</b>	<b>13,526.32</b>							<b>114,594.93</b>
<b>SHPENZIMET E KOMPANISË</b>													
<b>A PAGAT DHE MEDITJET</b>													
1 PAGAT NETO + SHUJTA	9,197.41	8,970.93	8,748.81	8,825.75	9,155.67	9,725.42							54,623.99
2 KONTRIBUTI I PUNEMARRSIT	499.37	494.01	481.43	485.38	504.18	536.32							3,000.69
3 KONTRIBUTI I PUNEDHËNESIT	499.37	494.01	481.43	485.38	504.18	536.32							3,000.69
4 TATIMI NE BURIM	413.86	414.88	398.06	396.16	423.78	464.49							2,511.23
5 MEDITJET E BORDIT													
<b>TOTALI</b>	<b>10,610.01</b>	<b>10,373.83</b>	<b>10,109.73</b>	<b>10,192.67</b>	<b>10,587.81</b>	<b>11,262.55</b>							<b>63,136.60</b>
<b>B TATIMET</b>													
1 TVSH-ja 8%	906.96	1,408.86	1,088.53	302.35	230.63	886.29							4,823.62
2 KESTETI TREMUJORE (ATK)													
3 TATIMI VJETOR MBI KORPORATA													
<b>TOTALI</b>	<b>906.96</b>	<b>1,408.86</b>	<b>1,088.53</b>	<b>302.35</b>	<b>230.63</b>	<b>886.29</b>							<b>4,823.62</b>
<b>C MALLRA DHE SHËRBIME</b>													
1 Shpenzime për karburant	2,439.54	2,182.18	1,961.03	2,224.42	2,315.75								11,122.92
2 Shpenzimet e depozitë (KMDK)	1,212.44	1,325.45	2,797.98	1,465.08	1,510.95								8,311.90
3 Shpenzimet për internet	127.12												127.12
4 Shpenzimet e Mirëmbajtjes së Mjeteve	2,126.53	3,094.51	1,405.00	1,826.41	1,123.42	1,356.84							10,932.71
5 Furnizim me Rrere I III													
6 Shpenzime për Softwer Kompjuterik					500.00								500.00
7 Shpenzime për Zyre dhe administrative	471.65	547.50	74.41	882.42	96.30	94.80							2,167.83
8 Shpenzime për pajisje dhe mjete pune	334.60	1,196.51	887.27	210.07	2,489.55	1,264.35							6,382.35
11 Shpenzime për trajnime													
12 Shpenzimet e Reprerzencionit	87.00	138.00	40.30	85.00		86.00							436.30
13 Shpenzimet e Sigurimit				9.03									9.03
14 Shpenzime Telefoni - (Mbusheje)	182.90	83.90	83.90	83.90	83.90	83.90							602.40
15 Provizione Bankare NIB BANK	12.90	13.70	14.10	12.10	23.00								75.80
16 Certifikata për shofer kamioni													
17 Certifikata shëndetësore punetor													
18 Shpenzime Higjienike													
19 Uniforma Pune													
21 Licence													
22 Shpenzimet e punes ne terren													
23 Shpenzimet e pazbritshme per qeshije tatimore	350.00	105.00	845.00	244.00									1,544.00
<b>TOTALI</b>	<b>7,344.68</b>	<b>8,686.75</b>	<b>8,108.99</b>	<b>7,043.18</b>	<b>8,142.87</b>	<b>2,885.89</b>							<b>42,212.36</b>
<b>D Shpenzime Komunale</b>													
1 Shpenzimet e Rrymes													
<b>TOTALI</b>													
<b>TOTALI SHPENZIMEVE (A+B+C)</b>	<b>18,861.65</b>	<b>20,469.44</b>	<b>19,307.25</b>	<b>17,538.20</b>	<b>18,961.31</b>	<b>15,034.73</b>							<b>110,172.58</b>

Përgjigjet e pyetjeve të kërkuara nga antarët e kuvendit.

1. Si të inkasojmë borgjet (a keni ndonjë plan)?

Sa i përket borgjeve ju kemi dërguar vërtet me shkrim në muajin Qershor (afat 15 ditë) ku një pjesë e madhe e klientëve ju kanë përgjigjur dhe ka pasur rezultat.

2. Bordi i kompanisë sa paguhet të ceket në raportin financiar?

Paga bruto e bordit të kompanisë është 123.68€



REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA - HANI I ELEZIT  
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN



010-5831\_2024

DATA :	<u>10/07/2024</u>
PËR :	KPF-Kuvendin Komunal
PËRMES	Mehmet Ballazhi-kryetar i Komunës
NGA :	Arsim Dernjani-Drejtor i DSHPE-së
LËNDA :	Informatë mbi sektorin Emergjent



Të nderuar antarë të Komitetit për politik dhe financa,të nderuar këshilltarë:

Me këtë shkresë përcjellëse po ju informoj në lidhje me sektorin e emergjencave për periudhën Janar-Qershor 2024.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe ka pas reshje të shpeshta të shiut ku ka pas edhe raste të daljes së ujit nga shtrati i proit ne veqanti në rrugën Driton dhe Gafurr Loku , ku pas daljes nga shtrati i proit jan krijuar edhe rrugët e pa pastruara me gurë, baltë etj me që rast jan angazhuar kompania "NPLPastrimi" për pastrimin e tyre.

Gjatë kësaj periudhe e specikisht me datë 21.05.2024 nga ora 16:20 fillon reshje të mëdha të breshërit ku si pasoj e reshjeve të mëdha jan krijuar dëme në (biznese, bujqësi, ekonomi familjare , vetura etj).

Pas përfundimit të breshërit komuna e Hanit të Elezit njofton të gjithë qytetarët të adresohen me kërkes për dëmet e shkaktuar nga breshëri me që rast kryetari i Komunës formon komisionin për vlersimin e dëmeve ku numri i kërkesave nga dëmet ka arritur në **836 sosh** me të cilët komisioni është në fazën finale për vlersimin e tyre dhe për procedim të mëtutjeshëm në nivelin qendror me shpresë për kompensim pasi që ne si nivel lokal nuk kemi mundësi kompensimi.

Vlera e dëmit të shkaktuar nga breshëri mundë të arrin shifrën afro **1,000,000.00 €**.

**RAPORTI I NJËSISË ZJARRËFIKJES DHE SHPËTIMIT JANAR-QERSHOR 2024**

2024	Nr. I daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. I daljeve Teknike	Nr. I sherbimeve	Aksidente rrugore	Vershime	Te rejshme	Të lënduar			Të vdekur		
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot
Janar	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shkurt	6	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mars	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Prill	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Maj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Qershor	2	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Korrik								0	0	0	0	0	0
Gusht													
Shtator													
Tetor													
Nëntor													
Dhjetor	0	0	0	0	0	0	0						
<b>Gjithsej</b>	<b>12</b>	<b>11</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

**P.S**

Vlenë të theksohet se Njësiti i zjarrëfikjes dhe shpëtimit ka pranuar një donacion në vlerë prej **13.000.00 €** nga KFORI Italian me pajisje dhe mjete të nevojshme për këtë sektor.

Me respekt,